



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Infermieri”

ofruar nga

Universiteti “Barleti”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Vjollca Durro

PhD. Juljana Xhindoli

Shtator /2025

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “INFERMIERI”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “Barleti”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Infermieri”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MASR Nr. 389, datë 08.07.2022
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 Vite akademike / 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 11 PAE/ 7 PAK 2023-2024 14 PAE/ 8 PAK 2024-2025 18 PAE/ 9 PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 36 Studentë 2023-2024 37 Studentë 2024-2025 35 Studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Barleti (UBa) është institucion jo publik i arsimit të lartë, hapur me VKM 571, datë 12.8.2005 si Shkolla e lartë Universitare, Jo publike Universiteti "Marin Barleti" me dy fakultete, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Matematikës së Zbatuar. Universiteti gjatë viteve e ka zgjeruar aktivitetin e tij me fakultete dhe programe të reja si dhe ka pësuar riorganizime. Me Urdherin nr. 309, datë 27.07.2012, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, "Riorganizim i Brendshëm i Njesive Kryesore të Shkolles së Lartë Universitare Jo Publike "Universiteti "Marin Barleti"", organizohet në katër fakultete: Fakulteti i Ekonomisë dhe Financës, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara. Me Urdhër 202, datë 25.05.2015 MARS dhe VKA nr 05.05.2015, Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike "Universiteti "Marin Barleti", organizohet me Fakulteti i Drejtësisë dhe shkencave Politike (5 njësi bazë) dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë (4 njësi bazë). Në vitin 2019 me Urdhërin nr. 511 datë 24.10.2019 të MARS "Universiteti Marin Barleti" Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale Politike riorganizohen në Fakultetin e Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit" me katër njësi bazë. Në vitin 2020 me me UMASR nr 213 date 03.07.2020 Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike "Universiteti "Marin Barleti"" riorganizohet në Universiteti "Barleti" me tre Fakultete. Me UMAS Nr. 117, date 09.03.2022 hapet njesia e re kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Aktualisht Universiteti "Barleti" përbëhet nga katër njësi kryesore:

1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë;
2. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative;
3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit;
4. Fakulteti i Shkencave Mjekësore;

Me UMASR 360 dt 23.12.2020 Miratohet Statuti i ri i Universitetit Barleti. Me UMAS Nr. 117, date 09.03.2022 hapet njesia e re kryesore Fakulteti i Shkencave Mjekësore, pas kesaj UBa ka bere ndryshime ne statut dhe organigrame me Vendim Senati Nr. 24, date 17.10.2022 dhe Vendim Bordi Nr. 9, date 18.10.2022. Keto ndryshime ne statut jane miratuar me UMAS Nr. 78, date 9.2.2023

UBa është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 9 datë 7.04.2017 dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 për një periudhë 5 vjeçare me vlefshmëri deri më 15.12.2026. UBa ofron programe studimi të ciklit parë, të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve. Programi i studimit të ciklit të parë bachelor në Infermieri ofrohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore i cili përbëhet nga tre departamente:

1. Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe Shëndetit;
2. Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike;
3. Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Zhvillimit Profesional;

Programi i studimit bachelor në Infermieri ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike, miratuar me Urdhër Urdhër MASR Nr. 389, datë 8.07.2022 dhe ofrohet me 180 kredite (ECTS), kohëzgjatje 3 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome bachelor në "infermieri".



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të herë të parë të programit të studimit Bsc në "Infermieri", i ofruar nga Fakultetin e Shkencave Mjekësore (FSHM). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit me karakter profesional, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 5 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit, Organizimi drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjytimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në fazë të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave]. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga **Prof. Dr. Vjollca Durro** dhe **PhD. Juljana Xhindoli**. Koordinator Teknik i ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Muhamed Preza. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në UBa e zhvilluar në datat 12 Mars 2025. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UBa. GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Universiteti "Barleti" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 22.07.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 50/26 Prot, datë 22.07.2025. Universiteti "Barleti" njofton më datë 29.07.2025, nëpërmjet shkresës me nr. 756, prot, datë 28.07.2025," *Kthim shkresës tuaj Nr. 50/26 prot, datë 22.07.2025*".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

1. Lidhur me komentin për Standardin III.1, kriteri 4

GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të stafit akademik si CV, diploma etj, të secilit pedagog, konstatoi se, fusha e formimit profesional të stafit akademik, në disa raste nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. Pedagogë me formim profesional në Biologji zhvillojnë lëndë mjekësore (si mikrobiologji, biokimi, deontologji mjekësore). GVJ i qëndron vlerësimit dhe rekomandimit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm. **Raporti nuk ndryshon.**

2. Lidhur me komentin për Standardin III.4, kriteri 5

Sipas evidencës (A.2.7 *Lista e aktiviteteve studentore të FSHM*), paraqiten korespondenca me email midis stafit akademik lidhur me aktivitete të ndryshme të organizuara nga studentet e Klubit të Mjekësisë. Vetëm në komunikimin e parë bëhet fjalë për një leksion të hapur për larjen e duarave, por nuk theksohen lektorët, numri i pjesëmarrësve, konfirmimi i pjesëmarrjes etj, që tregojnë realizimin e këtij leksioni të hapur. Pra kriteri flet për leksione dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda /jashtë strukturës së programit të studimit dhe jo aktivitete studentore. GVJ i qëndron vlerësimit dhe rekomandimit të bërë në raportin e vlerësimit të jashtëm. **Raporti nuk ndryshon.**



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Infermieri"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti "Barleti" (UBa) është institucion jopublik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 571, datë 12.8.2005 me dy fakultete, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe Fakultetin e Matematikës së Zbatuar. UBa është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 9 datë 7.04.2017 dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 për një periudhë 5 vjeçare me vlefshmëri deri më 15.12.2026. Gjatë viteve UBa ka shtuar programe dhe fakultetet të reja dhe ka pësuar disa riorganizime. Në vitin 2020 me Urdhërin nr. 213 datë 03.0.2020 të MASR Shkolla e Lartë Universitare Jo Publike Universiteti "Marin Barleti" riorganizohet në Universiteti "Barleti" (UBa) si vijon: 1. Fakulteti i Ekonomisë, Qeverisjes dhe Drejtësisë; 2. Fakulteti i Shkencave të aplikuara dhe Industrive Kreative; 3. Fakulteti i Shkencave Sociale, Turizmit dhe Sportit; Fakulteti i Shkencave Mjekësore hapet me UMAS Nr. 117, date 09.03.2022. Pas kësaj UBa ka bërë ndryshime në statut dhe organigramë të miratuar me UMAS Nr. 78, datë 9.2.2023. Fakultetet që janë në përberje të UBa e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat mjekësore, shkencat sociale dhe të aplikuara, shkencat ekonomike dhe të drejtësisë. Programet që ofron institucioni janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të vendit në përputhje me profilin e institucionit. Programet e studimit të ofruara nga institucioni kanë si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare dhe janë në përputhje të plotë me misionin e UBa, objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave Mjekësore, ekonomike, drejtësisë apo shkencave të aplikuara. <i>[takimi me stafin drejtues të FSHM, evidenca Ev.Nr.A.1.1. Statusi i institucionit, Rregullorja e Uba,</i>



	<i>Ev A1.2 Strategjia e zhvillimit institucional.,</i> <i>EvA1.2.1 Strategjia e ndërkombëtarizimit të UniBa,</i> <i>Ev. A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	UBa ofron programe studimi të ciklit të parë, programe të ciklit të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve, programe me karakter profesional, programe trajnimesh, testime dhe certifikime për aftësimin e arsimit të vazhdueshme. Programi i studimit bachelor në Infermieri ofrohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore (FSHM), pranë departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike. FSHM përbëhet nga tre departamente. Programi i studimit bachelor në Infermieri synon përgatitjen e profesionistëve në fushën e infermierisë nëpërmjet ofrimit të kurikulave edukuese dhe formuese në fushën e infermierisë të cilat janë në përputhje me misionin dhe objektivat e FSHM dhe Uba, duke i shërbyer zhvillimit mjekësor, social dhe ekonomik të shoqërisë shiptare si dhe përparimit të arsimit të lartë dhe kërkimor shkencor në nivel kombëtar. Programi i studimit është në përputhje me qëllimin, dhe veprimtarinë e institucionit për ofrimin e arsimit cilësor dhe me standarte Europiane për përgatitjen e individëve të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv. <i>[takimi me stafin drejtues të FSHM,</i> <i>Ev.Nr.A.1.1. Statusi i institucionit,</i> <i>Ev A 1.3 Rregullorja e Uba,</i> <i>Ev A1.2 Strategjia e zhvillimit institucional.,</i> <i>EvA1.2.1 Strategjia e ndërkombëtarizimit të UniBa,</i> <i>Ev. A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bachelor në Infermier.]</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Drejtimit prioritar akademike të institucionit janë përcaktuar në dokumentat themelore të tij si Statuti i UBa miratuar me Urdhër Nr. 78, datë 9.02.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “Për miratimin e një ndryshimi në Statusin e UBa” Strategjia e zhvillimit Institucional, miratuar me vendim të Bordit të Administrimit me nr. 111 Prot, datë 16.02.202, Rregullorja e UBa miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 7, datë 28.03.2023, ndryshuar me vendim të SA nr 83 datë 30.10.2024 , Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, miratuar me Vendim Nr. 21/2, datë 06.10.2022 të Senatit Akademik. UBa ka hartuar dhe miratuar edhe rregulloret e njësive dhe strukturave të tjera si rregullorja e departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike miratuar me vendim SA nr 21/4 datë

	6.10.2022, rregullorja e programit të studimit bachelor në infermieri miratuar me vendim të SA nr 1 datë 6.02.2023, rregullore NJSBC, rregullore e sekretarisë, rregullore e zyrës së burimeve njerëzore, Rregullore e brendshme per transferimet 2023, Rregullore e funksionimit te zyrave ne sherbim te studenteve prane UBa.etj. Ky program studimi është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor të UBa, statusin e e zhvillimit të UBa si dhe rregulloret e FSHM. Nga shqyrtimi i dokumentacionit. <i>[Ev.Nr.A.1.1. Statusi i institucionit;</i> <i>Ev A 1.3 Rregullorja e Uba,</i> <i>Ev A1.2 Strategjia e zhvillimit institucional,</i> <i>Ev. A.1.3 Rregullore e Universitetit Barleti.</i> <i>Ev. A.2.1 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore,</i> <i>Ev. A.2.3 Rregullore e Departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike.</i> <i>Ev.A 3.2 Rregullorja e programit të studimit bachelor në infermieri</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti “Barleti” ka një eksperiencë disa vjecare në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, programe të ciklit të tretë të studimeve, programe me karakter profesional, programe trajnimesh, testime dhe çertifikime për aftësimin e arsimin të vazhdueshme, Në përbërje të tij janë katër fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat mjekësore, sociale, ekonomike, juridike dhe shkenca te aplikuar. Kjo tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. Programi i studimit bachelor në Infermieri zhvillohet në FSHM në Departamentin e Shkencave Mjekësore Teknike, miratuar me Urdhër Urdhër MASR Nr. 389, datë 8.07.2022 dhe ofrohet me 180 kredite (ECTS). Institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike të mjaftueshme, që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit, me një numër më të madh studentësh, aktualisht 106 studentë në të tre vitet dhe dy studentë të çregjistruar. Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHM dhe UBa kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike QSUNT, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Spitalin Salus, Qendra Jonathan qendra

	Kombetare terapeutike dhe rehabilituse për fëmijë”, klinika Rusi etj. dhe jo publike si Qendrën e perkujdesit për të moshuarve Moza. <i>[Evidenca A.3.7 marrveshje në funksion të programit të studimit nstitucional, Aneks Tabela RVB per infermieri]</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit bachelor në infermieri zhvillohet nga FSHM dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të tij. FSHM përbëhet nga tre departamente: 1. Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe Shëndetit; 2. Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike; 3. Departamenti i Zhvillimit të përgjithshëm dhe zhvillimit profesional; Programi i studimit bachelor në Infermieri zhvillohet në Departamentin e Shkencave Mjekësore Teknike. Në FSHM për vitin akademik 2023-2024 sipas departamenteve zhvillohen 6 programe studimi is vijon: - Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe Shëndetit realizohen 2 (dy) programe Msc integruar; - Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike realizon tre programe studimi si vijon: Një program në MP dhe Dy programe Bachelor; - Departamenti i Formimit të përgjithshëm dhe zhvillimit profesional realizon një program studimi në Msc; Zhvillimi i procesit mësimor në FSHM, si njësia kryesore përgjegjëse për këtë program studimi realizohet nga pedagogë efektive (PAE) dhe pedagogë me kontratë (PAK) të cilët zotërojnë tituj akademik dhe grada shkencore. Profili i programit të studimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tij përputhet me atë të njësisë kryesore. <i>Ev.A 3.2 Rregullorja e programit të studimit bachelor në infermieri, Aneks RVB Tabela përmbledjesë per infermieri].</i>
Konkluzione	Programet që ofron UBa janë në përputhje me profilin e institucionit me qëllim ofrimin e arsimit cilësor dhe me standarte Europiane nëpërmjet një edukimi ndërdisiplinor për përgatitjen e individëve të angazhuar dhe me integritet në një mjedis social aktiv. Programet që ofron UBa janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të vendit dhe në përputhje

	me profilin e institucionit me qëllim ofrimin e arsimit cilësor dhe me standarte Evropiane. Programi i studimit bachelor në Infermieri zhvillohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe përputhet me fushën akademike dhe kërkimore të tij. Institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burime njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. Institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike të mjaftueshme, që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit, me një numër më të madh studentësh aktualisht (108 studentë në tre vitet).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UBa është një institucion që funksionon në bazë të akteve rregullatore, bashkëpunimit dhe koordinimit brenda institucionit të stafit akademik, administrativë dhe stafit mbështetës. Aktet ligjore rregullatore përcaktojnë organizimin, funksionimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e stafit sipas pozicionit dhe funksioneve që kryejnë në strukturat e universitetit, njësisë kryesore dhe bazë apo programit të studimit ku ata janë të angazhuar. Disa prej anëtarëve të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose angazhuar në komisione "ad hoc" të ngritura për tematika të ndryshme. Në mënyrë periodike njësia kryesore, njësitë bazë, programet e studimit dhe njësitë mbështetëse si NJSBC, sekretaritet mësimorë, këshillimi i karrierës, kryejnë analizën e aktivitetit të tyre, nxjerrin përfundimet dhe përcaktojnë masat që duhen të meren në zgjidhjen e problematikave të ndryshme apo përmirësimet e nevojshme. Në komunikimin e brendshëm midis stafit të institucionit një rol të rëndësishëm luan sistemi i komunikimit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	/intranet nëpërmjet se cilit realizohet shkëmbimi dhe përditësimi i informacionit, ndarja e punës, programet mësimore, orari mësimor, leksione, informacione për studentët etj. Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. <i>Takimi me dekanin, shefin e departamentit, stafin akademik, Ev. A.2.2 Raport vjetor i departamentit 2022 2023. Ev. A.2.2.1 Raport vjetor i departamentit 2023 2024</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	UBa është një institucion jo publik që ka një numër të konsiderueshëm studentësh në këtë program studimi si dhe një në numër programesh që ofron [Rregullorja e UBa]. Në funksion të këtij program studimi institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon si dhe ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet publike dhe jo publike, OJF, institucione shëndetësore. Pranë këtij departamenti është ngritur dhe Bordi i karrierës me përfaqësues nga departamenti, institucione shëndetësore dhe IAL. Për këtë program studimi UBa ka marrëveshje bashkëpunimi me QSUNT, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Spitalin Salus, Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Spitalin Salus, Spitali universitar i Traumës, Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, Qendrën e perkujdesit për të moshuarve Moza, Spitali Rajonal Korçë etj. Këto Marrëveshje bashkëpunimit me kompani apo institucione të ndryshme u mundësojnë studentëve kryerjen e praktikës profesionale, intershipte të cilat ju shërbejnë për thellimin e njohurive dhe përfitim të aftësive dhe komptencave profesionale si dhe vendosjen e kontakteve me biznesin për punësimin e tyre. <i>Takimi me stafin drejtues,</i> <i>Eivencia A.3.7 marrveshje në funksion të programit të studimit nstitucional, Aneks Tabela RVB per infermieri,</i> <i>Ev. A.2.12 Vendim për ngritjen e Bordit të Karrierës në FSHM.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave	Institucioni ka të dhëna lidhur me institucionet të sipërcituara ku, studentët kryejnë praktikën profesionale bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ka institucioni. Praktika mbikqyret nga një pedagog i caktuar si dhe kordinatori i programit i cili koordinon me institucionin ku studenti realizon praktikën profesionale. Realizimi i praktikës dhe vlerësimi kryhet sipas udhëzuesi "Paketa e praktikës" dhe regullores përkatëse të programit të studimit në infermieri.

profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<i>Ev.A3.8 Paketa e praktikës profesionale, takimi me stafin akademik,</i> <i>Ev. A.3.8.1 Model i një dosje praktike profesionale në Bachelor në Infermieri.</i> <i>Ev.A.3.8.2 Komisioni i vlerësimit për praktikën profesionale.</i> <i>Ev.A 3.2 Rregullorja e programit të studimit bachelor në infermieri.</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike ku zhvillohet ky program studimi, në mënyrë periodike harton raportin mbi realizimin e programit mësimor, opinionin e studentëve lidhur me logjistikën në funksion të programit, aktivitetet të kryera gjatë vitit akademik në funksion të programit të studimit. Të dhënat e raporteve i shërbejnë departamentit për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Numri i studentëve në programin bachelor është i qëndrueshëm gjatë tre viteve të para. <i>Takimi me stafin drejtues, vizita në sekretarinë mësimore, Aneks Tabela RVB per infermieri.</i>			
Konkluzione	<i>UBa është një institucion që funksion në bazë të akteve rregullatore, bashkëpunimit dhe koordinimit brënda institucionit të stafit akademik, administrativë dhe stafit mbështetës.</i> <i>Për realizimin e programit të studimit bachelor në infermieri institucioni ka infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme.</i> <i>IAL ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme të arsimit të lartë, me institucione shëndetësore publike dhe jo publike, OJF, për realizimin e programit dhe realizimin e praktikës profesionale.</i> <i>Pranë njesise baze ku realizohet ky program studimi është ngritur dhe Bordi i karrierës me përfaqësues nga departamenti, institucione shëndetësore, IAL.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit bachelor në Infermieri zhvillohet në Departamentin e Shkencave Mjekësore Teknike, miratuar me Urdhër Urdhër MASR Nr. 389, datë 8.07.2022. Sipas dokumentit të hapjes, programi ka filluar veprimtarinë akademike në vitin akademik 2022-2023. Ky program studimi i referohet nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është organizuar me 180 kredite (ECTS), kohëzgjatje 3 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e arsimit të lartë 80/2015. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome bachelor në “ Infermieri”, referuar nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). <i>Ev. A.2.1 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i> <i>Ev A 32.2 . Rregullor e programit të studimit bachelor në infermieri.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit bachelor në Infermieri synon dhënien e njohurive teorike dhe praktike në fushën e infermieristikës. Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucioni. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë bazë që shërbejnë formimit të përgjithshëm, lëndë specifike që kontribuojnë në edukimin dhe formimin profesional të studentit në shkencat mjekësore dhe në vecanti në infermieristikë, formimin e shprehive, aftësive dhe kompetencës profesionale në ofrimin e kujdesit shëndetësor që lidhen me nevojat e tregu të punës, lëndët ndërdisiplinare apo plotësuese që ndihmojnë në plotësimin e tyre me dije në informatikë, gjuhë të huaj, përfitimin e aftësive të komunikimit dhe prezantuese duke ndihmuar për pregatitjen dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit përmban një informacion të plotë në fushën e kujdesit infermior nëpërmjet ndërthurjes së informacione dhe njohurive të shkencave mjekësore me ato të shkencave sociale. <i>Ev A 32.2 . Rregullore e programit të studimit bachelor në infermieri.</i>

	<i>Ev A3.10 Plani mësimor</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Kurikula dhe përmbajtja e Programit të studimit krijojnë mundësi studentit për formimin e tij profesional në fushën e infermieristikës. Niveli i dijeve të ofruara në programet e lëndëve është i përshtatshëm për formimin e tyre profesional dhe ofron njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në fushën e shkencave mjekësore dhe vecanërshtit në infermieristikë si dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës jo vetëm brënda vëndit po dhe jashtë tij. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurikula e tij ju krijojnë mundësi punësimi studentëve në struktura shëndetësore. Programi studimit përmban të gjitha elementët e organizimit bazuar në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018. Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët si vijon: A. Lendet bazë 35 ETC/ 19 % (15-20%); B. Lëndët karakterizuese 94 ETC/ 52 % (50-55%); C. Lëndë ndëdisiplinore /integruese 22 ETC/12% (12-15%); D. Lëndë plotësuese 24 ETC/13% (10-15%); E. Detyrime përmbyllëse 5 ETC/2.7% (3-5%); <i>Ev A 32.2. Rregullore e programit të studimit bachelor në infermieri.</i> <i>Ev A3.10 Plani mësimor, A.3.11 Syllabuse e programit të studimit bachelor në infermieri.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët duke përfshirë kreditet për praktikës profesionale e cila në total ka 18 ETC 450 orë (200 orë në vitin e dytë dhe 250 orë në vitin e tretë) dhe detyrimet përmbyllëse 5 ETC. <i>Ev A 32.2 . Rregullore e programit të studimit bachelor në infermieri.</i> <i>Ev A3.10 Plani mësimor, A.3.11 Syllabuse e programit të studimit bachelor në infermieri.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e	N / A

arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Në takimin me stafin drejtues të Fakultetit të Shkencave Mjekësore u referua së në hartimin e këtij program studimi janë bazuar në programet të ngjashme me IAL kombetare dhe sidomos Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti Mjekësisë Tiranë. Ngjashmëria e këtij program me programe të ngjashme është mbi 70%. <i>Takimi me stafin drejtues të FSHM, RBV</i> <i>A.3.11 Syllabuse e programit të studimit bachelor në infermieri.</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Kodifikimi i programit të studimit Bachelor në “Infermieri” bazohet në Ligjin e Arsimit të lartë nr 80/2015 datë 22.07.2015. Kodifikimi i programit është kryer nga MASR me urdhër Urdhër nr 389 datë 8.07.2022 dhe percillet institucionit me shkresën Nr prot 431, datë 27.03 2023 “Kodet e propozuara për programet e studimit ofruar nga universiteti Barleti”. Ky process akoma nuk përfunduar nga MAS. <i>Ev A.1.31 Kodet e propozuara për programet e studimit ofruar nga universiteti Barleti</i> <i>Ev A3.6. Kodifikimi i programit</i>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Aktualisht programi i studimit Bachelor në “Infermieri” nuk është program i përbashkët me IAL të tjera, por në takimet me stafin drejtues dhe pedagogë të FSHM u theksua se mbetet një nga synimet e këtij institucioni <i>Takimi me stafin drejtues dhe akademik,</i> <i>Ev.Nr.A.1.1. Statusi i institucionit,</i> <i>Ev A 1.3 Rregullorja e Uba,</i> <i>Ev A1.2 Strategjia e zhvillimit institucional</i>
Konkluzione	<i>Ky program studimi i referohet nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), është organizuar me 180 kredite (ECTS), kohëzgjatje 3 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi.</i>

	<i>Kurikula dhe përmbajtja e Programit të studimit krijojnë mundësi studentit për formimin e tij profesional në fushën e infermieristikës.</i> <i>Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët duke përfshirë kreditet për praktikës profesionale e cila në total ka 450 ore ose 18 ETC dhe detyrimet përmbyllëse 5 ETC.</i> <i>Në përfundim të studimeve lëshohet diplome bachelor në Infermieri referuar nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kodifikimi i programit është kryer nga MASR dhe percillet institucionit me shkresën Nr prot 431, datë 27.03 2023 "Kodet e propozuara për programet e studimit ofruar nga universiteti Barleti".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislationin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	UBa është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutit të tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Tiranë. Institucioni përbëhet nga njësitë kryesore, bazë, ndihmës akademike dhe administrative dhe organet këshilluese(bordet e ndryshme). UBa ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional në vitin 2017 me vendim të BA nr.9, datë 07.04.2017 dhe dhe riakredituar në vitin 2021 me Vendim BA Nr. 60, datë 16.12.2021 me vlefshmeri akreditimi deri në vitin 2026. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore i organizuar në tre departamente: 1. Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit (i cili realizon 2 programe studimi cikli të dytë Msc (PI)); 2. Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike (i cili realizon 2 programe studimi cikli të parë Bsc dhe një program studimi i ciklit të dytë MP);

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

	3. Departamenti i Formimit të përgjithshëm dhe Zhvillimit Profesional (i cili realizon 1 program studimi cikli të dytë). Programi i studimit në fjalë zhvillohet në Departamentin e Shkencave Mjekësore Teknike të FSHM, miratuar me Urdhër MASR Nr. 389, datë 8.07.2022 dhe ofrohet me 180 kredite (ECTS), kohëzgjatje 3 vite akademik, në gjuhën shqipe dhe kohë të plotë studimi. Në përfundim të studimeve lëshohet diplome Bachelor në “Infermieri. Për realizimin e programit të studimit në njësinë kryesore dhe njësinë bazë janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë të kualifikuar që zotëorjnë tituj dhe grada shkencore. Përbërja e stafit akademik në njësinë bazë për 3 vitet e fundit akademike është si më poshtë: - Viti akademik 2024-2025, 8 PAE (1 Prof. Dr., 2 Dr., 5 Msc) dhe 8 PAK (2 Prof. As., 4 Dr., 2 Msc); - Viti akademik 2023-2024, 7 PAE (1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 1 Dr., 4 Msc) dhe 11 PAK (1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 3 Dr., 6 Msc); - Viti akademik 2022-2023, 7 PAE (1 Prof. As., 2 Dr., 4 Msc) dhe 7 PAK (2 Prof. As., 3 Dr., 2 Msc); UBa ka respektuar parashikimet ligjore mbi përbërjen e Departamentit për të tre vitet akademike në shqyrtim. <i>Aneks Tabela përmbledhëse për programin Bsc Infermieri & dokumentacioni shtesë.</i> <i>Ev. A.3.2 Rregullore e programit Bsc Infermieri,</i> <i>Evidenca A.1.3. Rregullore e UniBa</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia bazë ku realizohet programi i studimit ka angazhuar staf ndihmës akademik/laborant me kualifikimin Bsc dhe ndihmes administrative për realizimin e programit mësimor, realizimin e praktikave mësimore, praktikave profesionale në mbështetje të studenteve. Departamenti ka dhe një person akademik që ndjek praktikën profesionale. <i>Aneks Tabela përmbledhëse për programin Bsc Infermieri.</i> <i>Ev. A.3.2 Rregullore e programit Bsc Infermieri, takimi me stafin drejtues dhe akademik</i>

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Institucioni ka një koordinator për çdo departament i cili koordinon marrëdhëniet midis studentëve dhe departamentit për të gjitha programet që ofron departamenti. Koordinatori i Departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike, i cili kryhen dhe koordinonin e programit Bsc në infermieri bazuar në aktet rregullatore të UBa, është pedagog me kontratë nga Fakulteti i Shkencave mjekësore emëruar me vendim të rektorit të UBa nr 25 datë 14.10.2022. <i>Takimi me stafin drejtues,</i> <i>evidenca A2.10 v. A.2.10 Urdhër i Rektorit për emërimin e Koordinatorit të Departamentit.</i> <i>Ev A1.3 rregullore e Universitetit Barleti.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit bachelor në Infermieri është licensuar sipas legjislacionit në fuqi. Staf i akademik i angazhuar në njësinë kryesore dhe bazë ku realizohet ky program studimi është i kualifikuar me tituj dhe grada shkencore.</i> <i>Institucioni ka një koordinator për çdo departament i cili koordinon marrëdhëniet midis studentëve dhe departamentit për të gjitha programet që ofron departamenti. Koordinator i departamentit është njëkohësisht dhe koordinatori i programit të studimit i miratuar me vendim të rektorit të UBa.</i> <i>Njësia bazë ku realizohet programi i studimit ka angazhuar staf ndihmës akademik/laborant Bsc dhe ndihmes administrative për realizimin e programit mësimor, realizimin e praktikave mësimore, praktikave profesionale në mbështetje të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton se departamenti disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	çdo lëndë si dhe sekretaria mësimore. Dokumentacioni i programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, planin mësimor, orarin e mësimi. <i>Ev. A.3.2 Rregullore e programit Bsc Infermier, takimi me stafin akademik dhe studentët.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura e programit të studimit Bsc në "Infermieri", përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018 Programi i studimit është i organizuar në lëndë teorike dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 3 vite akademike të ndara në 6 semestra. Numri i ECTS është 60 ECTS për çdo vit akademik, në total 180 ECTS. Në çdo vit akademik janë 1500 orë mësimore prej të cilave të ndara sipas viteve orë në auditor janë respektivisht 854 orë në vitin e parë, 810 orë në vitin e dytë dhe 765 orë janë në vitin e tretë, 18 ETC ose 450 ore praktika profesionale(cila kryhet sipas syllabusit përkatës dhe programit kalendarik në vitin e dytë dhe të tretë) dhe Diploma 5 ETC. Programi mësimor është i organizuar në leksione, seminare, ushtrime/laboratore. Pjesë e programit të studimit është dhe praktika profesionale. Plani mësimor përshin lëndet/disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurrikulare. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, ushtrimeve, praktikave laboratorike, detyrave të kursit, prezantimeve. Frekuentimi i orëve teorike dhe praktike është i detyrueshëm për studentin në masën 50% për leksionet, 75% për praktikën profesionale, seminare dhe labororet. Kohëzgjatja e orëve të mësimi është 50 minuta. <i>Ev. A.3.2 Rregullore e programit Bsc Infermier,</i> <i>Ev. A.3.11 Syllabuset e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri.</i> <i>Ev. A.3.10 Plani mësimor</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstaton se institucioni ofron informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Në

kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	takimin me studentët rezultoi që studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kriteret specifike përzgjedhëse në pranimin e tyre. <i>Ev. A.1.13 Manual për rekrutim, aplikim, rregjistrim dhe transferim studimesh.</i> <i>Ev. A.1.16 Rregullore e Brendshme për Transferimet dhe rregjistrimet në programet e dyta.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban informacionin lidhur me syllabuset që zhvillon në programin e studimit Bsc në "Infermieri". Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas një formati të miratuar dhe përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, praktikë mësimore/ profesionale, ECTS përkatëse, literaturën përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit bazuar në VKM nr.185 datë 25.03.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.1.2018. Programi ka udhëzues/paketa për praktikën profesionale ku përfshihen tematika dhe udhëzime lidhur me realizimin e saj, numri i orëve të praktikës profesionale dhe ETC përkatëse. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ gjithashtu konstaton se: <i>Ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor. Ligji përcakton qartë se titullarët e lëndëve duhet të jenë të kategorisë Prof. As. ose Prof. Dr. Për sa më sipër, GVJ rekomandon që institucioni të marrë masat që titullarët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor.</i> <i>Ev. A.3.11 Syllabuset e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri."</i> <i>Ev. A.3.10 Plani mësimor, Aneks Tabela përmbledhëse</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Në takimim me stafin akademik u theksua se syllabuset përditësohen nga pedagogët dhe miratohen në fillim të çdo viti akademik. Ky është një program i ri studimi dhe nuk mund të bëhet rishikim i programit pa kryer procesin e akreditimit. <i>Takimi me stafin akademik</i>
Konkluzione	<i>Departamenti disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin</i>



	ketë program studimi nga petagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore. Institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit. Ka lëndë që titullari i lëndës nuk është i kategorisë profesor. Bazuar në legjislacionin mbi arsimin e lartë Titullatët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor. <u>GVJ rekomandon që Titullatët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria "Profesor"</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimët të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit bachelor në Infermieri është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademike të ndarë në gjashtë semestra në total 180 ECTS (ose 60 ECTS në vit) nga të cilat 18 ECTS i përkasin praktikës profesionale. Në total në të tre vitet akademike programi mësimor realizon 4500 orë mësimore nga të cilat 2402 orë realizohen në auditor. Në gjykimin e GVJ-së mjaftojnë dhe janë të përshtatshme për njohuritë që duhet të ketë një specialist infermier. <i>Ev. A.3.11 Syllabusët e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri."</i> <i>Ev. A.3.10 Plani mësimor, Aneks Tabela përmbledhëse</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike dhe praktike në fushën e shkencave mjekësore, menaxhim të proceseve të punës, zgjidhjen e probleme të vecanta të pacientit dhe përshtatjen e tyre në tregun e punës, etj. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit të studimit.

rezultateve të pritshme të të nxënit.	Ev. A.3.2 Rregullore e programit Bsc Infermier Ev. A.3.10 Plani mësimor, Aneks Tabela përmbledhës.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit është organizuar në leksione, seminare, ushtrime/laboratore dhe praktika profesionale me ngarkesën përkatëse në kreditë konvertuar në orë mësimore në auditor dhe jashtë auditorit/ punë të pavarur të studentit. Nga shqyrtimi i programit dhe planit mësimor GVJ konstaton shpërndarje promovionale të ETC midis lëndëve bazë, lëndëve specifike, lëndëve integruese dhe praktikës profesionale bazuar në legjislacionin në fuqi. Një vënd të rendesishëm në programin e studimit profesional për aftësimi praktik të studentëve zë praktika profesionale e cila përbën 10% të orëve të programit mësimorë ose 18 ETC. Nga 4500 ore 1244 ore janë pune individuale dhe 3256 orë në auditor, 450 orë praktika profesionale dhe 1709 orë janë praktika mesimore & laboratore. Pra orët e praktikës mësimore dhe praktika profesionale që i shërbejnë formimit profesional të studentit dhe perfitimit të kompetencës profesionale përbëjnë reth 48% të orëve të programit mësimor. Ev. A.3.10 Plani mësimor, Aneks Tabela përmbledhës.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Organizmi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme profesionale. Me njohuritë e mara në këtë program studentët e ndjejnë veten të aftë për ushtrimin e profesionit të tyre dhe përshtatjen me tregun e punës. Ev. A.3.10 Plani mësimor, Aneks Tabela përmbledhës Ev. A.3.11 Syllabuset e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri., takimi me stafin akademik dhe studentë.
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Në takimin me stafin akademik u theksua se Programet e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në fillim të cdo viti akademik, për fitimin e njohurive dhe kompetences në fushën e infermieristikës, menaxhim të proceseve të punës, zgjidhjen e probleme të vecanta të pacientit dhe përshtatjen e tyre në tregun punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse. Cdo pedagog është përgjegjës për lëndën e tij ku më pas firmosen edhe nga drejtuesi i departamentit. Ev. A.3.11 Syllabuset e programit të studimit "Bachelor" në "Infermieri., takimi me stafin akademik dhe studentë

Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Tematikat që trajtohen në programin e studimit i shërbejnë formimit profesional të studentëve në një fushë profesionale sic është infermiera ku dijet në shkencat mjekësore ndërthuren me ato të shkencave sociale duke ju përgjigjur në këtë mënyrë kërkesave të tregut të punës. Zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS, zhvillimi i orëve laboratorike dhe praktikës profesionale ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme për ushtrimin e profesionit të tyre. Institucioni, u ka ofruar mundësi studentëve për trajnime apo marrje pjesë në aktivitetet të ndryshme ekstrakurrikulare , që janë në funksion të formimit të tyre profesional. <i>Ev. A.3.11 Syllabuset e programit te studimit "Bachelor" ne "Infermieri", takimi me stafin akademik dhe studentë,</i> <i>Ev. A.1.24 Manual i Klubeve Studentore 2024 2029.</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Bsc në infirmieri siguron marrjen e njohurive bazë në edukimin dhe formimin e studentëve në profesionin e infermieri. Këto njohuri i shërbejnë studentëve për formimin e tyre profesionale dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës profesionale si dhe ju mundëson atyre vijimin e studimeve në ciklet e tjera të studimit. Pike e fortë e programit të studimit është bordi i karrierës i cili ndihmon ne krijimin e kontakteve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave për punësimin e tyre si dhe bashkepunimin me biznesin për përmirësimin e programit të studimit, nevojat e tregut të punës. <i>Ev. A.3.11 Syllabuset e programit te studimit "Bachelor" ne "Infermieri, Takimi me studentë.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bsc në infermieri është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademik të ndarë në gjashtë semestra në total 180 ECTS (ose 60 ECTS në vit) nga të cilat 18 ECTS i përkasin praktikës profesionale.</i> <i>Programi dhe plani mësimor ka shpërndarje promociionale të ETC midis lëndëve bazë, lëndëve specifike, lëndëve integruese dhe praktikës profesionale ku 10% praktika profesionale dhe 38% praktika mësimore dhe laboratore.</i>



	<i>Për aftësimin praktik të studentëve një vënd të rëndësishëm në programin e studimit profesional zë praktika profesionale e cila përbën 10 % të orëve të programit mësimor ose 18 ETC.</i> <i>Tematikat që trajtohen në programin e studimit, shpërndarja e ngarkesës mësimore ore/ETCS, në orë laboratorike dhe praktikës profesionale ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programi, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive dhe kompetencës të nevojshme për ushtrimin e profesionit të tyre duke ju përgjigjur në këtë mënyrë kërkesave të tregut të punës.</i> <i>Pike e forte e programit të studimit është bordi i karrierës i cili ndihmon në krijimin e kontakteve të studentëve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave për punësimin e tyre si dhe bashkëpunimin me biznesin për përmirësimin e programit të studimit, nevojat e tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Njësia bazë çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe për përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në këtë proces një vend të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me përfaqësues nga institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, përfaqësues të biznesit, studentët e diplomuar. <i>Ev. A.3.7 Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të programit të studimit, Takimi me stafin akademik</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime	Pjesë e rishikimit apo përditësimit të programit mësimor janë dhe propozimet e bëra nga studentët që janë në process



studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	studimi. Ky është një program studimi dhe ende nuk janë diplomuar studentët e brezit të parë në këtë program studimi. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshilli studentor dhe senatin akademik. Në takimin me studentë u theksua se janë të interesuar në rritjen e orëve të praktikës profesionale që i shërben aftësimit të tyre praktik dhe fitimin e kompetencës profesionale. <i>[Takimi me studentët dhe stafin akademik.]</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Çdo vit akademik njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi bën përditësim të kurikulave. Një vend të rëndësishëm në këtë proces zënë shkëmbimet e ekseperiencave me programe të njëjta të stafit akademik dhe studentëve, organizimet e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar apo urdhërat profesionale në fushën e shëndetit. Por sic jemi shprehur edhe më sipër, ky program po akreditohet për herë të parë dhe nuk ka pasur mundësi të bëjë ndryshime thelbësore. <i>Takime me stafin akademik dhe studentët</i>			
Konkluzione	<i>Njësia bazë çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe përshtatja me kërkesat e tregut të punës në bashkëpunim me institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, përfaqësues të biznesit apo urdhrin profesionist.</i> <i>Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshilli studentor, senatin akademik.</i> <i>Një vend të rëndësishëm në këtë proces zënë shkëmbimet e ekseperiencave me programe të njëjta të stafit akademik dhe studentëve, organizimet e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar nga fusha e biznesit apo urdhërat profesionale në fushën e shëndetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																				
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për zhvillimi i procesit mësimor dhe transmetimin e dijeve programi i studimit përdor metoda të ndryshme si leksione, seminare, laboratore, detyra kursi, prezantime, projekte, praktika profesionale. GVJ në takimin me stafin akademik konstatoi se në programin e studimit zbatohen metoda inovative, platforma dhe sisteme që ndërthurin metodikën standarde të mësimdhënies me komunikimin on line. Syllabuset e programit të studimit dhe plani mësimor janë hartuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe përmbajnë të detajuara format e mësimdhënies/mësimnxënies. Në tabelë paraqitet në mënyrë të detajuar ndarja e orëve sipas formave të mësimdhënies dhe ndarja e tyre në orë në auditor/punë e pavarur e studentit, sipas tabelës së planit mësimor. <table><tr><th>Program Bsc Infermieri</th><th>Viti I</th><th>Viti II</th><th>Viti III</th></tr><tr><td>Në auditor</td><td>854</td><td>1010</td><td>1032</td></tr><tr><td>- Leksione</td><td>384</td><td>307</td><td>231</td></tr><tr><td>- Seminare</td><td>108</td><td>67</td><td>54</td></tr><tr><td>- Laboratore</td><td>245.5</td><td>75</td><td></td></tr><tr><td>- Trajnim Praktik</td><td>116</td><td>561</td><td>712</td></tr><tr><td>- Prova finale</td><td></td><td></td><td>35</td></tr><tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td>646</td><td>490</td><td>108</td></tr><tr><td>Praktika profesionale</td><td></td><td></td><td>450</td></tr></table>	Program Bsc Infermieri	Viti I	Viti II	Viti III	Në auditor	854	1010	1032	- Leksione	384	307	231	- Seminare	108	67	54	- Laboratore	245.5	75		- Trajnim Praktik	116	561	712	- Prova finale			35	Punë e pavarur e studentit	646	490	108	Praktika profesionale			450
Program Bsc Infermieri	Viti I	Viti II	Viti III																																		
Në auditor	854	1010	1032																																		
- Leksione	384	307	231																																		
- Seminare	108	67	54																																		
- Laboratore	245.5	75																																			
- Trajnim Praktik	116	561	712																																		
- Prova finale			35																																		
Punë e pavarur e studentit	646	490	108																																		
Praktika profesionale			450																																		

	Gjithsej	1500	1500	1590
<i>Ev. A.3.10 Plani mësimor, Aneks Tabela përmbledhës</i>				
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Në takimin me stafin u informuam se në mësimdhënie përdoren metoda alternative si prezantime në power point., biseda interaktive me studentët apo prezantimi i temave të veçanta nga studentët dhe diskutimi i tyre, etj. Staf akademik është bashkëpunues dhe mbështetës si në pjesën teorike të zhvilluar në auditor ashtu dhe në zhvillimin e trajnimit praktik në laboratorët mësimor në FSHM apo qendrat me të cilat UBa ka marrëveshje bashkëpunimi. Një rol të rëndësishëm në organizimin e procesit mësimdhënës luan dhe koordinatori i programit mësimor. Për t'iu përgjigjur kërkesave të kohës, stafi është përfshirë në trajnime, konferenca, shkëmbim eksperiencie në kuadër të programit Erasmus, aktivitete on-line për shkëmbime eksperiencash etj. në funksion të promovimit të metodologjive bashkëkohore në mësimdhënie në përputhje me tipologjinë e programit mësimor. <i>Evidencat A.2.5 lista e aktiviteteve të Fakultetit të shkencave Mjekësore</i> <i>Evidenca A3.11 syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri.,</i> <i>Takimet me stafin dhe studentët në institucion</i>			
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesëmarrje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, aplikimi në projekte shkencore të cilat kanë një buxhet për publikime sic janë projekte të mbështetur nga AKSHI, RIDI etj. Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve si auditorët janë të paisur me forto projektorë, kompjutera, laboratorët mësimorë të infermierisë, anatomisë, histologjisë etj. Institucioni ka përgatitur një paketë dokumentash dhe praktikash për realizimin e mësimdhënies, për përdorimin e teknologjisë dhe politikat e publikimit. <i>Evidencat A.2.5 lista e aktiviteteve të Fakultetit të shkencave Mjekësore</i>			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program	Programi i studimit Bsc në "Infermieri" realizohet në Departamentin e Shkencave Mjekësore Teknike. Hartimi i syllabuseve dhe mësimdhënia e lëndëve të profilit mjekësor			

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	garantohet nga personel akademik i Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Referuar tabelës përmbledhëse t RVB, për realizimin e procesit mësimor në këtë program studimi janë angazhuar në mësimdhënie personel PAE dhe PAK me tituj dhe grada shkencore. Referuar dokumentacionit të stafit akademik (Cv dosja individuale e stafit akademik) konstatohet se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bsc në “Infermieri” ka përgatitje ka kualifikimin e duhur, kompetencë dhe eksperiencë në mësimdhënie. Nga shqyrtimi i dokumentacionit <i>GVJ konstatoi se fusha e formimit profesional të stafit akademik, në disa raste nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. Pedagogë me formim profesional në Biologji zhvillojnë lëndë mjekësore (si mikrobiologji, biokimi, deontologji mjekësore).</i> <i>GVJ rekomandon shpërndarjen e lëndëve mësimore stafit akademik sipas formimit të tyre professional dhe fushës së ekspertizës që zotërojnë.</i> <i>Ev. A.3.14 Cv e stafit akademik të programit të studimit.pdf, A. Evidencat A.2.5 lista e aaktiviteteve të Fakultetit të shkencave Mjekësore, Tabelat e RVB,</i> <i>Takimi me Dekanin dhe Shefin e Departamentit,</i> <i>A3.11 syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri., Takimet me stafin dhe studentët në institucion</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit. Anketimi i studentëve organizohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike në bashkëpunim me Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë dy herë në vit. Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit. Në takimin me studentët ata u shprehën se shpjegimi është i qartë dhe reflekton përdorimin e metodave inovative. Në orën e mësimi ka bashkëveprim interaktiv pedagog-student. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë pedagog-student që reflektohet dhe në realizimin e konferencave studentore. Institucioni përdor disa mekanizma për monitroimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies si: - Këshilli i vlerësimit të performancës; - Raportet e kordinatorit të performancës;

	- Vlerësimi i pëdagogut nga ndjekja e lëksioneve nga dekani ose shefi i njësisë bazë për lektorët dhe asistent lektorë; - Zhvillimi i lëksioneve të hapura; - Pyetësori i studentëve. <i>Evidenca A.1.35. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën, Takimi me studentët në institucion</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka 2 struktura që koordinojnë dhe bashkëveprojnë me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. 1. Komisioni i Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, organ kolegjal i përhershëm që siguron orientim, këshillim, mbështetje në hartimin e politikave dhe procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë; 2. Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, njësi autonome në nivel institucioni që monitoron; vlerëson, zhvillon dhe përmirëson cilësinë e veprimtarisë së UniBa; Njësia e zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë përgatit raporte vjetore që i ve në dispozicion të njësive kryesore/bazë. Këto raporte ndihmojnë në evidentimin e problematikave dhe përmirësimin e vazhdueshëm. UBa mbështet dhe nxit zhvillimin profesional dhe kualifikimin shkencor të personelit akademik. Në institucion janë zhvilluar trajnime për stafin akademik. Në takimin me stafin drejtues u theksua se nga buxheti i institucioni UBa buxheti për kërkimet shkencor zë 10% të buxhetit total, i cili këtë vit akademik është përdorur për fuqizimin e FSHM. Në takimet me stafin akademik u konstatua fryma positive e institucionit në raport me bashkëveprimin hierarkik dhe horizontal në nivel njësie qëndrore dhe njësie bazë. Në takimin me zyrën e kërkimit shkencor u informuam se pedagogët janë të përfshirë në programin e mobilitetit Erasmus+ (vizitë në universitetin e Budapestit) përmes të cilit fitojnë eksperiencë në mësimdhënie dhe në fusha të kërkimit shkencor. Një Studentë nga ky program në kuadër të programit të mobilitetit të studentëve ka qnë në universitetin e Drazenit. Gjithashtu është hapur dhe thirja për studentët për të aplikuar për programet e mobilitetit të studentëve me universitetet partnere. FSHM është përfshirë në programin RID me anë të aplikimit për dy projektë (Lidërsip mnë infermieri me Univ Torvergata në Rome, Capacity building, Ngritja e qëndrës së




	ndihmës së parë) si dhe 3 aplikimë të AKSHI. Këto projekte i krijojnë stafit mundësi komunikimi me akademikë të diasporës dhe kontribuojnë për ngritjen e kapaciteteve shkencore në institucion. <i>Evidencat A.1.10. Rregullore e NJZHKC, A.1.9. Rregullore e komisionit të sigurimit të standardeve të cilësisë,</i> <i>A.1.39. Raport për vlerësimin dhe cilësinë, Takimet në institucion.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</i> <i>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve.</i> <i>Institucioni ka ngritur struktura që koordinojnë dhe bashkëveprojnë me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Institucioni mbështet dhe promovon aktivitetin shkencor të stafit akademik.</i> <i>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë pedagogjike në lëndët që zhvillon, por nga shqyrtimi dokumentacionit në disa raste GVJ konstatoi se fusha e formimit profesional të stafit akademik nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. Pedagogë me formim profesional në Biologji zhvillojnë lëndë mjekësore (si mikrobiologji, biokimi, deontologji mjekësore.</i> <i>GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve ku formimi profesional i pedagogut të përputhet me lëndën që ai do realizoj në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e	Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit, në syllabuse dhe planin mësimor shkruhen qartë kriteret dhe procedurat e vlerësimit, detyrimet që duhet të përmbushen për të hyrë në provim, mënyra e zhvillimit të provimit dhe të dhënat mbi dokumentimin e vlerësimit (procedura e ankimimit dhe rivlerësimit). Në takimin me studentët GVJ diskutoi dhe mbi mënyrën e informimit për vlerësimin në provime përmes sistemit të brendshëm të informacionit. <i>Evidencat A.1.3. Rregullore e UBa, A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri,</i> <i>A3.11 syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri, takimi me studentët</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në syllabuset e lëndëve/ moduleve të përgatitura nga titullari i lëndës shkruhet qartë metodologjia e vlerësimit të njohurive. Studentët informohen që në fillim për kushtet e frekuentimit, detyrimet për t'u plotësuar dhe kriteret e vlerësimit. Në rregulloren e programit të studimit theksohet se vlerësimi i dijeve është gjithë vitin dhe bëhet i vazhdueshëm. Sistemi vlerësimit është më pike të cilët konvertohen me notë nga 1 – 10 (nota kaluese 5/ vlerësimi maksimal 10). Në programin e studimit Bsc në “Inferieri” një vend të rëndësishëm zë dhe praktika për përfitimin e aftësive profesionale. Institucioni ka përgatitur “Paketën e praktikës” në të cilën detajohet procedura e vlerësimit të studentit në të gjithë komponentët e saj duke filluar nga frekuentimi, cilësitë etike dhe aftësitë e ndryshme profesionale (sipas lëndëve). <i>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri, Ev.A.3.8 Paketa e praktikës profesionale</i> <i>A3.11 Syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/ praktika, provimi diplomimit. Procedura e testimit të njohurive mbështetet në Rregulloret e institucionit dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i dijeve bëhet në përputhje me planin e studimit dhe zhvillohet në tre sezona: sezoni dimrit, verës, vjeshtës. <i>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri, Ev.A.3.8 Paketa e praktikës profesionale</i> <i>A3.11 Syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri.</i>

Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik në fillim të cdo viti akademik rishikon dhe përmirëson metodat që përdoren për zhvillimin e procesit mësimor dhe transmetimin e dijeve te studenti, leksionet apo bën përditësim të literaturës. Në këtë proces rishikimi merren për bazë dhe sygjerimet apo kërkesat e referuar nga studentët gjatë procesit mësimor. <i>Takimi me stafin akademik, takimi me studentët.</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në programin e studimit institucioni ka angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie në lëndët mjekësore dhe me karakter përgjithshëm. Për transmetimin e dijeve dhe aftësimin profesional të studentit stafi akademik përdor metoda të ndryshme dhe fleksible. Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve, diskutimet e rasteve klinike në seminare, praktika mësimore dhe veçanërisht ato profesionale. Institucioni inkurajon studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme në mënyrë të pavarur duke ju vënë në dispozicion laboratorët mësimor mjekësor, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në në aktivitetet që organizon departamenti, temave të ndryshme për një ceshtje të caktuar, projekte të mobiliteti. Këto metoda sigurojnë bashkeveprimin dhe vendosjen e marrëdhënieve të respektit midis studentiot dhe pedagogut. Institucioni ka siguruar të gjithë logjistikën e nevojshme për realizimin e procesit mësimor. <i>A3.11 Syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri., takimet me studentët dhe stafin akademik</i>
Konkluzione	<i>Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve, diskutimet e rasteve klinike në seminare, praktika mësimore dhe veçanërisht ato profesionale.</i> <i>Institucioni inkurajon studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme në mënyrë të pavarur duke ju vënë në dispozicion laboratorët mësimor mjekësor, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik.</i> <i>Procedura e testimit të njohurive mbështetet në Rregulloret e institucionit dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i dijeve bëhet në përputhje me planin e</i>

	studimit dhe zhvillohet në tre sezone: sezoni dimrit, verës, vjeshtës Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në rregulloren e FSHM dhe atë të programit të studimit vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuse përcaktohen komponentët e vlerësimit dhe pesha specifike e tyre: - provimi i ndërmjetëm 20%; - pjesmarrja, aktivizim dhe detyrat e kursit 20% ; - provimi përfundimtar 60%; Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në bazë të rregullores së programit të studimit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/pedagogu. Nota minimale kaluese është nota 5 për të cilën duhen akumuluar të paktën 50 pikë. Nota maksimale është nota 10 që merret kur studenti akumulon 95 – 100 pikë. Megjithë akumulimin e pikëve vjetore, provimi përfundimtar është i detyrueshëm.
	A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri, A3.11 Syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri.

Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Metoda e përdorur është testimi me gojë, me shkrim me sekretim të të dhënave të studentit nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore, me qëllim ruajtjen e anonimatit të studentit. Pasqyrimi i vlerësimit të studentit kryhet nëpërmjet portalit studentor, sistem që iu mundëson studentëve informimin në kohë reale për rezultatet akademike, informacione për lektorët etj. UBa ka ngritur sisteme të koordinuara për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe të dhënave të tjera akademike e administrative. Ne të ardhmen institucioni po punon për futjen e metodave të testimit on line dhe në këtë program studimi. <i>Evidenca A.1.12.1 Udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit,</i> <i>Anex RVB, takimet në institucion</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim nga një komision i përbërë nga pedagogët e lëndës. Kur lënda zhvillohet nga një pedagog, komisioni përbëhet nga dy pedagogë kur njëri është pedagogu i lëndës. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollon nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Në përfundim të procesit mësimor pedagogu i lëndës i komunikon studentit fitimin ose jo të mundësisë për të hyrë në provim (bazuar në informacionin e sekretarisë mësimore për frekuentimin dhe pagesat) dhe rezultatin e vlerësimit të vazhduar. Procesverbali i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogët që kanë realizuar provimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit. <i>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri, Ev.A.1.35 Formulari i vlerësimit të studentëve për lëndën. A3.11 Syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Rregullorja e programit të studimit përcakton ECTS teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studenti duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi. Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Studenti ka të drejtë të shohë rezultatet e provimit të cilat komentohen nga pedagogu. Studenti ka të drejtë të ankimojë rezultatin e provimit. <i>Evidencat A.1.3 Rregullore e UBa,</i> <i>A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri,</i>

Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UBa ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Në rregulloren e studimeve në kodin e etikës dhe në fund të çdo syllabusi rastet e kopjimit apo plagjiaturës konsiderohen të ndaluara. Stafi akademik i departamentit organizon dhe monitoron zhvillimin e provimit duke respektuar rregulla strikte për moslejimin e kopjimit. Salla e provimit monitorohet nga pedagogët e komisionit të provimit, sekretarija mësimore apo te dërguar nga dekanati. Nuk lejohen telefonat gjatë provimit. Në rregulloren e FSHM janë të përcaktuar dhe sanksionet përkatëse nëse studenti kopjon, apo përdor telefon gjatë provimit. <i>Evidencat A.1.14. Kodi i Etikës, A.3.2 Rregullpre e programit të studimit Bsc në infermieri,</i> <i>A3.11 syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Procedura e dhënies së rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohet në rregulloren e FSHM dhe programit të studimit. Departamenti i garanton studentëve vlerësimin bazuar në meritë. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 5 ditëve pas zhvillimit të provimit. Fleta e provimit plotësohen dhe firmosen nga pedagogët që realizojnë provimin dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. <i>A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri,</i> <i>A3.11 syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Rregullorja e FSHM dhe programit të studimit parashikon studentit të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin para se vlerësimi të marrë formë përfundimtare. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. <i>Ev. A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e	Studenti ka të drejtën e ankimimit me shkrim te drejtuesi i departamentit brenda 48 orëve nga marrja e rezultatit nëse nuk është dakord me rezultatin e provimit dhe sqarimin nga pedagogu i lëndës. Nëse pas verifikimit prej tij, kërkesa nuk gjen zgjidhje, përgjegjësi i departamentit informon dekanin.

ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Dekani brenda 48 orëve ngrë një komision ad-hoc dhe bën verifikimet përkatëse. Komisioni mund të vendosë të lërë në fuqi vlerësimin aktual, të ndryshojë vlerësimin ose të urdhërojë përsëritjen e provimit me një komision tjetër. E gjithë procedura e ankesës dhe rivlerësimi të studentit dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore. <i>Ev.A.2.1 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.</i> <i>Ev. A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Bazuar në rregulloren e FSHM dhe atë të programit të studimit vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuse përcaktohen komponentët e vlerësimit dhe pesha specifike e tyre.</i> <i>Provimi realizohet me shkrim. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. UBa ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngrë struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore teknike përgatit specialistë në infermieri për të cilët nevojat e tregut të punës janë të shumta. Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e shërbimit infermior për t'iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë shqiptare në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore, përfshi shtimin e nevojës për infermierë në sistemin spitalor dhe në sistemin ambulator. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe



	praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika mësimore dhe ajo profesionale. <i>Tabelat e RVB,</i> <i>Ev. A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri.</i> <i>A3.11 syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë dhe karakterizuese që japin informacion të përgjithshëm (anatomia, fiziologji, fispatologjia) apo specifik profesional për kujdesin në situata të ndryshme si urgjencë, peditari, në grupmosha të ndryshme, në shërbime të ndryshme klinike etj., përmban edhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, informatikë-statistikë etj. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Praktika profesionale e zhvilluar në subjekte publike apo private krijon premisë për shtimin e aftësive komunikuese dhe ndërvepruese. <i>Evidencat A.3.10 Plani mësimor,</i> <i>A3.11 syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri ,</i> <i>Ev. A.3.7 Marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.	Në çdo syllabus percaktohet kompetencat dhe aftësitë që duhet të ketë studenti në përfundim të ciklit mësimor të lëndës përkatëse. Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orientojnë studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të tyre. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Provimet dhe format e tjera të testimit si dhe plotësimi i detyrimeve përmblylëse pasqyrojnë shkallën e përfitimit të njohurive dhe analizohen në fund të vitit në mbledhjet e stafit akademik. <i>A3.11 Syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri, takimet me studentët dhe stafin akademik.</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra	Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, me aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit dhe për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës për ndihmën dhe asistencën e individëve pacientë apo grupeve në nevojë. Në

në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	programin Bsc në infermieri janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie në lëndët mjekësore dhe ato të formimit të përgjithshëm. Gjatë programit të studimit studentët fitojnë njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit. Programi i studimit bazohet në punën individuale të studentit dhe mësimin në auditor. Gjatë realizimit të procesit mësimor stafi akademik mbështet punën në grup të studentëve, diskutimet e rasteve klinike në seminare, praktika mësimore dhe veçanërisht ato profesionale. Institucioni inkurajon studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në në aktivitetet që organizon departamenti, në projekte të ndryshme mobiliteti apo projekte në komunitet si përfshirja në ditët e promovimit të shëndetit si dita e diabetit, hipertensionit etj. <i>A3.11 Syllabuset e programit të studimit bsc në infermieri, takimet me studentët dhe stafin akademik.</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në funksion të një përgatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquar vendas apo të huaj. Në këto aktivitete krahas lektorëve të ftuar përfshihen dhe lektorë nga stafi akademik i UBa. <i>Këto u theksuan në takimet me stafin akademik por, nuk ka dokument të shkruar për realizimin e këtyre aktiviteve si tematika, lektorët pjesëmarrës.</i> <i>Rekomnadojmë që në të ardhmen ky proces të dokumentohet.</i> <i>Takimet me studentët dhe stafin akademik</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bsc që ofrohet nga Departamenti i Shkencave Mjekësore teknike përgatit specialistë në infermieri për të cilët nevojat e tregut të punës janë të shumta. Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e shërbimit infermieror për t'iu përgjigjur kërkesave të shoqërisë shqiptare në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore, përfshi shtimin e nevojës për infermiere në sistemin spitalor dhe në sistemin ambulator.</i> <i>Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion</i>

	të një përgatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesëmarrjen e personaliteteve të shquar vendas apo të huaj. Rekomnadojmë që në të ardhmen ky proces të dokumentohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në fund të studimeve studenti pajiset me diplomë Bsc "Infermieri", pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur provimin përfundimtar. Prova finale në këtë program studimi realizohet në formën e provimit përfundimtar ose me temë diplome. Procedura për detyrimet përmbyllëse bazohet në Rregulloren e UBa dhe në Rregulloren e programit të studimit. Rregullorja e programit të studimit e njeh studentin me kushtet e diplomimit, detyrimet që duhet të përmbushë studenti, pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome është nota 8. Studentët njihen me procedurën dhe në takimet informuese të realizuara nga departamenti. <i>Ev. A.1.3 Rregullore e UBa</i> <i>Ev. A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri.</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Objekti i këtij program studimi është përgatitja e specialistëve infermierë me aftësi teorike dhe kompetencë profesionale për tu përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit. Në fillim të vitit të fundit të studimeve, pedagogët e Departamentit i orientojnë studentët dhe iu japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final. <i>Ev. A.1.3 Rregullore e UBa,</i> <i>Ev. A.3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri, Takimet me stafin dhe studentët</i>

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi studimit finalizohet me Provim përfundimtar kur nota mësimore është nën 8. Testimi bazohet në njohuritë e marra gjatë programit të studimit. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat që përfshihen në programin e studimit. Komisioni i ngritur me propozim të departamentit përgatit tezën përfundimtare e cila firmoset dhe aprovohet nga Përgjegjësi i departamentit. Provimi përfundimtar i formimit mund të zhvillohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mënyra e organizimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar përcaktohet në rregulloren e programit të studimit. <i>Ev. A.1.3 Rregullore e UBa,</i> <i>Ev. A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri, Takimet me stafin dhe studentët</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Programi Bsc në infermieri finalizohet me temë diplome kur nota mësimore është mbi 8. Tema përcaktohet në semestrin e dytë në vitin e tretë. Projektpropozimi për provën finale/teme diplome bëhet nëpërmjet plotësimi të një formulari të vecantë që dorësohet kordinatorit të programit. Komiteti shkencor i programit shqyrton dhe miraton projektpropozimin si dhe udhëheqësin e temës. Tema e miratuar regjistrohet në regjistrin e provës finale. Udhëheqësi i jep mbështetjen akademike dhe konsulencë studentit që ai të realizoj punimin e diplomës me cilësi të lartë dhe në kohën e duhur. Mbështetja dhe konsulenca konsiston në përzgjedhjen e temës, përpilimin e strukturës, zgjedhjen e literaturës, prezantimin e tij përpara komisionit të vlerësimit. Komisioni i vlerësimit propozohet nga komiteti shkencor i programit dhe miratohet nga titullari i njësive kryesore. Vlerësimi bëhet me pikë të cilat konvertohen në notë sipas rregullores përkatëse. <i>Ev. A3.12 Paketa e provës finale.</i> <i>Ev. A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermieri.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në hartimin e temës diplomës studenti ndihmohet dhe mbështetet nga udhëheqësi i temës dhe institucioni cili i siguron studentit bazën e nevojshme materiale dhe logjistikën për realizimin e punimit. <i>Ev. A3.12 Paketa e provës finale.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm	Vlerësimi i studentit në provimin përfundimtarë apo temën e diplomës bëhet me pikë të cilat konvertohen në notë dhe fiton

përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	kreditet sipas planit mësimor. Rregullorja e programit të studimit përcakton gjithashtu sezonet për provimin përfundimtar (i verës dhe i dimrit), modalitetet për riprovimin në rast moskalimi në sezonin e parë dhe procedurën për paisje me diplomë (jo diplomë) në rastet kur studenti rrëzohet përsëri në riprovim. <i>Ev. A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermier</i> <i>Ev. A3.12 Paketa e provës finale.</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit, studenti pajiset me Diplomë përkatëse dhe suplementin e diplomës. Diploma është hartuar sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Modeli i diplomës është hartuar sipas akteve rregullatore të miratuar nga MASH dhe e regjistruar nga QSHA. Në fund të studimeve me kërkesë të studentit bashkë me diplomën i vihet në dispozicion dhe programi i studimit të kryer. <i>Ev. A 3.2 Rregullore e programit të studimit Bsc në infermier.</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar. Institucioni mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretariatë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i arritjeve akademike dhe regjistri i tërheqjes së diplomës dhe çertifikatave. Administrimi i dokumentacionit të mësipërm bëhet në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Rregulloren e sekretarisë mësimore. GJV inspektoi mënyrën e ruajtjes së dokumentacionit dhe plotësimin e regjistrave në sekretarinë mësimore dhe i gjeti ato konform ligjit dhe rregulloreve. Procedura e ruajtjes, arkivimit apo asgjësimit të dokumentacionit parashikohet në Rregulloren e Protokollit dhe Arkivës. <i>Ev. A.1.19. Rregullore për funksionimin e sekretarisë mësimore,</i> <i>Ev.A.1.20. Rregullore e protokollit dhe arkivës.</i>
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Bsc në "Infermieri" dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</i> <i>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë profesionale pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1						
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.						
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie përbëhet nga pedagogë me eksperiencë dhe përgjithësisht me kualifikimin e duhur profesional sipas fushave të mësimdhënies. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, staf akademik të angazhuar në tre vitet akademike janë si më poshtë:					
	2022-2023		2023-2024		2024-2025	
	Tituj/ grada	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE
	Prof.Dr.	-	-	1	1	1
	Prof. Asoc.	1	2	1	1	-
	Dr./PhD.	2	3	1	3	2
	Msc.	4	2	4	6	5
Totali		7	7	7	11	8
Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit në përgjithësi ka përgatitje profesionale dhe eksperiencë pedagogjike në lëndët që zhvillon, por nga shqyrtimi i dokumentacionit në disa raste <i>GVJ konstatoi se</i>						

	<i>fusha e formimit profesional të stafit akademik nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. Për shembull, pedagogë me formim profesional në Biologji zhvillojnë lëndë mjekësore (si mikrobiologji, biokimi, apo deontologji mjekësore. Ka pedagogë që realizojnë me shumë se tre lëndë në disa raste. Bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi, këto janë elementë që bien në kundërshtim me të.</i> <i>GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së lëndëve ku formimi profesional i pedagogut të përputhet me lëndën që ai do realizojë si dhe të ketë një shpërndarje më të drejtë të lëndëve duke mos kaluar numrin maksimal të lejuar.</i> <i>Evidencë. Tabela permbledhese 6.1/ 6.2/ 6.3/ tab. 7 e stafit akademik.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Mjekësore mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me kornizën ligjore dhe aktet rregullatore. Rektori dërgon udhëzime për konfirmimin e stafit dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore çdo vit. Koordinatorin informon pedagogët e rinj për procedurat mësimore dhe zëvendësimet. UniBa angazhon gjithashtu personel ndihmës për orët e ushtrimeve dhe laboratorëve, duke siguruar mbështetje administrative për studentët. <i>Gjithsesi, GVJ konstaton se personeli akademik efektiv realizon 64% të ngarkesës mësimore ndërsa ai me kontratë 36%. Pavarësisht se kemi një lufatje të lehtë, GVJ rekomandon institucionin të marrë masa për plotësimin e kuadrit ligjor.</i> <i>Evidencë. Plani mësimor I lidhur me personelin akademik Tabela 12.1, 12.2, 12.2/1, 12.3, 12.3/1.</i> <i>Evidencë. A. 2. 8. Stafi akademik FSHM dhe ngarkesa mësimore</i> <i>Ev. A.3.10 Plani mësimor. Aneks RVB Tabela permbledhese Infermieri.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e	GVJ vëren se Institucioni siguron qëndrueshmërinë e personelit akademik gjatë periudhës së akreditimit, përfshirë kontratat e punës dhe sigurimet shoqërore. Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm konfirmoi stabilitetin e stafit akademik. Procesi i rekrutimit përputhet me Ligjin Nr. 80/2015 dhe aktet rregullatore të brendshme. Të gjitha kontratat respektojnë

akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	aktet ligjore për arsimin e lartë, Kodin e Punës dhe Ligjin për Sigurimet Shoqërore. Procedurat dhe kriteret e rekrutimit janë të publikuara dhe të aksesueshme në faqen zyrtare të UniBa. Përgjatë viteve shihet një përpjekje e vazhdueshme e institucionit për të angazhuar staf me përvojë dhe tituj akademik sipas kriterëve të Arsimit të Lartë. <i>Evidencë. A. 1. 22. Manual i menaxhimit të burimeve njerëzore</i> <i>Evidencë. A.1.23. Formati dosjes personale të stafit</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni ndjek procedura të qarta rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike për të siguruar përzgjedhjen e personelit të kualifikuar në përputhje me programet e studimit. Grupi i vlerësimit të jashtëm, pas shqyrtimit të dokumentacionit, konfirmoi se UniBa ka një politikë të hapur rekrutimi, duke nisur me evidentimin e nevojave nga njësitë çdo fillim semestri. Kërkesat depozitohen pranë ZMBNj, e cila publikon shpalljet për vendet vakante. GVJ verifikoi në mënyrë rastësore dosjet e personelit akademik efektiv dhe me kontratë, kontratat e punës, nga ku u verifikua korrektësia e tyre sipas kërkesave të ligjit dhe listës së përmbajtjes së dosjes. UniBa vlerëson performancën bazuar në kriteret objektive, duke ofruar mundësi të barabarta për stafin akademik dhe administrativ. Vlerësimi mat rezultatet e punës në përputhje me standardet e përcaktuara dhe realizohet sipas procedurave të dokumentuara. Në fund të vitit akademik, Njësia e Kërkimit Shkencor kryen një analizë të punës kërkimore bazuar në raportet vjetore të departamenteve. <i>Ev. A.1.22 Manuali i menaxhimit të Burimeve Njerëzore.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm, pas shqyrtimit të dokumentacionit, konfirmoi se UniBa ka angazhuar 1 personel ndihmës akademik për orët e ushtrimeve dhe laboratorëve. Institucioni siguron angazhimin e mjaftueshëm të personelit ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike dhe mirëmbajtjen e mjediseve mësimore, në përputhje me natyrën e programit të studimit, bazuar kjo në planin mësimor dhe nga vizita në institucion. Nga komunikimi me studentët konstatuam se personeli administrativ dhe akademik ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke garantuar mbarëvajtjen e procesit mësimor.

	<i>Vizita në institucion.</i> <i>Ev. A.3.10 Plani mësimor.Aneks RVB Tabela permbledhese Infermieri.pdf</i> <i>Ev. A.1.30 Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ në takimin në institucion në zyrën e burimeve njerëzore konstatoi se kjo zyrë ka të ruajtuara dhe të përditësuara të dhënat e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, sipas programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. Dosjet ishin të rregullta dhe zyra e burimeve njerëzore ishte e kujdesshme mbledhjen dhe ruajtjen e tyre. <i>Ev. A.1.23 Format i dosjes personale të stafit. Ev. A.3.10 Plani mësimor.pdf</i> <i>Aneks RVB Tabela permbledhese Infermieri. Ev. A.1.22 Manuali i menaxhimit të Burimeve Njerëzore.</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Grupi i vlerësimit të jashtëm, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion konfirmoi se UniBa zbaton në mënyrë të planifikuar shpërndarjen e praktiës profesionale sipas një plani të caktuar me rotacion në institucionet përkatëse me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Institucioni ka bërë një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione shëndetësore, spitale, shërbim parësor dhe klinika shëndetësore publike dhe private, për të realizuar praktikatat mësimore, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës profesionale me personel të kualifikuar. Marrëveshje bashkëpunimi ndër institucionet shëndetësore më kryesore, përmendim: 1. Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë, Tiranë; 2. Spitali Universitar i Traumës; 3. Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Tiranë;

	4. Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza; 5. Spitali Salus Tirana; 6. Spitali Universitar Shefqet Ndroqi, Tiranë; Institucioni mban komunikim të vazhdueshëm me partnerët për të garantuar akomodimin e studentëve në praktika. Mbikëqyrja realizohet nga stafi akademik, i cili siguron që zhvillimi i praktikës të jetë në përputhje me standardet. Studentët e diplomuar mbrojnë diplomën përmes provimit të përgjithshëm ose punimit të diplomës. Për këtë, janë në dispozicion dokumentet e bashkëpunimit, paketa e praktikave profesionale dhe rregullorja përkatëse të programit të studimit. <i>Ev. A.3.8.1 Model i një dosje praktike profesionale në Bachelor në Infermieri.pdf</i> <i>Ev. A.3.8 Paketa e praktikave profesionale.pdf</i> <i>Ev. A.3.10 Plani mësimor.pdf</i> <i>Ev. A.3.7 Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të programit të studimit.pdf</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ nga takimi me pedagogët dhe studentët konfirmoi se praktika mësimore zbatohet konform rregulloreve të përcaktuara të praktikës. Koordinator i praktikës bën koordinimin e studentëve në vendet e caktuara për praktikën profesionale në fillim të semestrit duke i kontaktuar me mbikqyrësin e praktikës në vendin e punës në institucionin shëndetësor. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës, pas përfundimit të praktikës firmos në fund dosjen e praktikës profesionale të studentit që përbëhet nga skeda e praktikës, formulari i vlerësimit të praktikës dhe raportin e praktikës. <i>Ev. A.3.8.1 Model i një dosje praktike profesionale në Bachelor në Infermieri.pdf</i> <i>Ev. A.3.8 Paketa e praktikave profesionale.pdf</i> <i>Ev. A.3.12 Paketa e provës finale.pdf</i>
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se në përgjithësi personeli akademik i angazhuar në programin Bachelor në "Infermieri" përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimet e nevojshme, por në disa raste fusha e formimit profesional të stafit akademik nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi. Ka pedagogë që

	realizojnë me shumë se tre lëndë, dhe <u>GVJ rekomandon të merren masat për rregullimin e tyre.</u> Institucioni garanton qëndrueshmërinë e stafit dhe ndjek procedura të qarta rekrutimi dhe vlerësimi. Zyra e burimeve njerëzore ishte e kujdesshme mbledhjen dhe ruajtjen e tyre. GVJ gjithashtu vëren se UniBa ka angazhuar personel ndihmës për orët e praktikave dhe laboratorëve, si dhe ka nënshkruar marrëveshje me institucione shëndetësore për realizimin e praktikave profesionale. Praktikantët zbatohen sipas rregulloreve, me mbikëqyrje të kualifikuar dhe vlerësim të plotë nga personeli mbikëqyrës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatoi se institucioni ka një infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e orëve mësimore teorike dhe laboratorike. Institucioni siguron mjedise të përshtatshme për aktivitetet mësimore, duke u përputhur me numrin e studentëve dhe natyrën specifike të programeve të studimit. Ambjentet ofrojnë kushte të mira për mësimdhënie dhe janë të pajisura me ajrosje, ndriçim dhe sistem mbrojtjeje nga zjarri. Sallat janë të pajisura me karrige dhe banka komode, të përshtatshme për qëndrime të zgjatura. Po ashtu, institucioni ka ambjente për praktikën dhe mundësi rekreacioni. Angazhimi i UniBa për ndërtimin e një godine të re dhe rikonstruktimin e ekzistueses garanton kushte bashkëkohore për zhvillimin profesional të aktiviteteve dhe krijimin e një mjedisi modern. <i>Ev. A.2.18 Infrastruktura e UniBa në funksion të programeve të DSHMT.pdf</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), gjatë vizitës në institucion dhe komunikimeve me studentët, konstatoi se të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, duke garantuar

pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	realizimin efektiv të procesit mësimor teorik dhe praktik. Një nga objektivat kryesorë strategjike të UniBa është digjitalizimi. Në kampusin e ri të UniBa, auditorët disponojnë tabela dhe sisteme projektimi digjital, si dhe mjete audio dhe video të nevojshme. I gjithë kampusi do të mbështetet me një rrjet WiFi dhe pajisje elektronike si kompjuterë, laptopë, printerë dhe skanerë, si në zyrat e stafit akademik ashtu edhe në ato administrativ. <i>Ev. A.1.12 Intraneti.pdf</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), gjatë vizitës në institucion, konstatoi se laboratorët e infermierisë janë të pajisur me bazën materiale të nevojshme për realizimin e lëndëve profesionale dhe lehtësimin e praktikimit të teknikave të ndryshme profesionale infermiere. Laboratorët e anatomisë dhe histologjisë, si dhe të tjerat, janë të personalizuar dhe të specializuara sipas llojit dhe profilit të moduleve që zhvillohen. Çdo mjedis ofron ambjentet dhe mjetet e domosdoshme për zhvillimin cilësor të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke përmbytur të gjitha standardet e kërkuara. Mjediset gjithashtu ofrojnë facilitete për aspektin praktik dhe stimulojnë mësimnxënien tek studentët. <i>Ev. A.2.18 Infrastruktura e UniBa në funksion të programeve të DSHMT.pdf</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), gjatë vizitës në institucion, konstatoi se institucioni ka në dispozicion 4 laboratorë të teknologjisë së informacionit. Këta laboratorë mbështesin jo vetëm nevojat e studentëve, por ofrojnë gjithashtu të gjitha programet dhe aplikacionet e nevojshme për programin e studimit. Laboratorët janë të aksesueshëm me internet dhe disponojnë videoprojektorë për te ilustruar dhe shpjeguar materialet për pedagogun dhe studentët. <i>Vizita në institucion (laboratorët).</i> <i>Ev. A.2.18 Infrastruktura e UniBa në funksion të programeve të DSHMT.pdf</i>
Konkluzione	<i>Institucioni disponon infrastrukturë të mjaftueshme për zhvillimin e orëve mësimore teorike dhe laboratorike. Mjediset mësimore janë të pajisura me teknologji moderne, duke garantuar realizimin efektiv të procesit mësimor. Në kampusin e universitetit "Barleti", auditorët janë të pajisur me tabela</i>

	digjitale dhe mjete audio-vizuale, ndërsa i gjithë kampusi mbështetet me rrjet WiFi dhe pajisje elektronike. Ambjentet ofrojnë kushte komode për mësimdhënie dhe janë të pajisura me ajrosje, ndriçim dhe sistem mbrojtjeje nga zjarri. Laboratorët, përfshirë ato të infermierisë, anatomisë dhe histologjisë, janë të specializuara dhe ofrojnë mjetet e nevojshme për zhvillimin e lëndëve profesionale. Gjithashtu, laboratorët e teknologjisë së informacionit janë të pajisur me kompjutera që mbështesin programet e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstatoi se literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve garanton marrjen e njohurive të nevojshme për përgatitjen e specialistëve në fushën e shkencave mjekësore. Pas vizitës në bibliotekën e UniBa-s dhe takimeve me pedagogët, u vërtetua se literatura është e mirë organizuar, me tekste mësimore dhe materiale shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja. Biblioteka ofron akses të menjëhershëm në literaturën e nevojshme, e cila përzgjidhet me kujdes nga lektorët. Në rastet kur literatura nuk është e disponueshme, Departamenti i Infermierisë inkurajon që lektorët të bëjnë kërkesë për blerje çdo vit akademik. <i>Gjithsesi, GVJ sugjeron që institucioni të mbështesë pedagogët efektiv për botimin e cikleve të leksioneve në gjuhën shqipe të përshtatura me kurrikulat përkatëse, duke siguruar një proces mësimor më të efektshëm me literaturë të viteve të fundit.</i> <i>Ev. A.2.9 Literatura në Bibliotekë për Shkencat Mjekësore.pdf</i> <i>Ev. A.2.14 Kërkesë për Përditësimin e Fondit të Librave për Vitin Akademik të Ri.pdf</i>

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Rritjen e fondit të bibliotekës dhe zgjerimin e aksesit në burimet online e gjejmë në politikën institucionale, ku në fillim të vitit akademik, çdo departament paraqet një listë të re librash që duhet të shtohen në bibliotekat fizike dhe online, për të mbështetur programet e studimit dhe nevojat përkatëse. <i>Gjithsesi GVJ mendon se ka nevojë akoma për përditësime apo botime ciklesh leksionesh sic jemi shprehur me sipër.</i> <i>Ev. A.2.9 Literatura në Bibliotekë për Shkencat Mjekësore.pdf</i> <i>Ev. A.2.14 Kërkesë për Përditësimin e Fondit të Librave për Vitin Akademik të Ri.pdf</i> <i>Ev. A.1.25 Rregullore e Bibliotekës.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm në Bibliotekën e Universitetit Barleti, u konstatua se kjo bibliotekë ka ofruar shërbime që nga themelimi i universitetit në vitin 2005. Ajo është organizuar në hapësira të ndryshme për të qenë sa më afër studentëve. Njësia kryesore e bibliotekës, e vendosur në katin e parë, ka një sipërfaqe prej 27.3 m² dhe përmban 18 poste leximi dhe 5 kompjuterë. Biblioteka zgjerohet më tej në një hapësirë prej 95.1 m², ku janë arkivuar revistat shkencore, punimet e konferencave dhe periodikët, duke ofruar gjithashtu 50 poste leximi dhe kompjuterë për qasje në bibliotekën dixhitale dhe burime online ndërkombëtare. Në katin përdhe, biblioteka zgjerohet në 70 m², me 27 poste leximi dhe kompjuterë për qasje në burimet dixhitale. Ambientet janë të dizajnuara për të ofruar mundësi të qeta për lexime dhe për punë grupore. Sistemi i menaxhimit të bibliotekës, i bazuar në platformën digjitale, mundëson kategorizimin e titujve dhe siguron shërbim të shpejtë dhe efikas për stafin dhe studentët. <i>Ev. A.1.25 Rregullore e Bibliotekës.pdf</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha	Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm në Bibliotekën e Universitetit Barleti, u konstatua dhe u morën informacione rreth fondit fizik të bibliotekës. Ajo është e pajisur me një sërë materiale, përfshirë tekste mësimore bazë dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaja, si dhe libra dhe revista shkencore të nevojshme. Biblioteka ofron një fond të pasur me tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse, përfshirë revista shkencore pedagogjike, të cilat janë thelbësore për mbulimin e moduleve të programit. Synim kryesor shihej pasurimi i vazhdueshëm me tituj të rinj çdo vit, për të mbuluar në mënyrë efektive modulet e

moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	programit. Literatura fizike mund të shfrytëzohet brenda ambienteve të bibliotekës ose të merret me vete, në varësi të llojit dhe numrit të kopjeve të disponueshme për secilin titull. Si ndihmë, ofrojmë një listë titujsh përkatës për programin e studimit. <i>Ev. A.2.9 Literatura në Bibliotekë për Shkencat Mjekësore.pdf</i> <i>Ev. A.1.25 Rregullore e Bibliotekës.pdf</i> <i>Ev. A.1.25.1 Platforma e bibliotekës online.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm, u konstatua se Universiteti Barleti ofron kushte të favorshme për studentët për akses në një sërë bibliotekash online. Biblioteka dixhitale EconBiz, me të cilën universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi, ofron rreth 96,847 artikuj në fushën e studimeve europiane. JSTOR siguron qasje në mbi 12 milion artikuj dhe burime në 75 disiplina, duke lejuar stafin dhe studentët të lexojnë online dhe të ruajnë materialet e dëshiruara. Po ashtu, biblioteka ofron burime si OpenDissertations.org dhe DOAJ, me akses në disertacione dhe revista shkencore. Institucioni krijon lehtësira për akses falas në titujt e bibliotekës online dhe fizike, si dhe ambiente për lexim të bibliotekës dhe për ti tërhequr ata. Ofrimi i fotokopjes në bibliotekë dhe printimeve falas gjithashtu lehtëson procesin e mësimnxënies. Studentët kanë mundësinë të tërheqin tituj fizikisht dhe të informohen mbi kredencialet e aksesit online. <i>Ev. A.2.9 Literatura në Bibliotekë për Shkencat Mjekësore.pdf</i> <i>Ev. A.1.25 Rregullore e Bibliotekës.pdf</i> <i>Ev. A.1.25.1 Platforma e bibliotekës online.pdf</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Gjatë vizitës GVJ, konstaton se biblioteka e Universitetit Barleti është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, të cilat ofrojnë akses në bibliotekën dixhitale të universitetit dhe në burime online ndërkombëtare. Platforma ofron mundësi për anëtarët të kërkojnë libra, t'i rezervojnë ato, ose të bëjnë kërkesë për rezervim në rast mungese, me një proces të menaxhuar nga stafi i bibliotekës përmes postës elektronike. Biblioteka disponon një kompjuter qëndror i lidhur me serverin online, duke lejuar studentët të aksesojnë burimet nëpërmjet kompjuterëve të bibliotekës ose ëireless nëpërmjet aplikacioneve celulare.

	Studentët janë orientuar për përdorimin e kësaj platforme për të shfrytëzuar lehtësisht literaturën dhe titujt e nevojshëm për programet e studimit. <i>Ev. A.2.9 Literatura në Bibliotekë për Shkencat Mjekësore.pdf</i> <i>Ev. A.1.25 Rregullore e Bibliotekës.pdf</i> <i>Ev. A.1.25.1 Platforma e bibliotekës online.pdf</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm, u konstatua se biblioteka është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë orarit zyrtar të punës së institucionit, i cili është nga 08:00 deri në 19:45. Në intervalin nga 08:30 deri në 16:30, stafi akademik, studentët dhe stafi jo mësimdhënës mund të bëjnë kërkesa dhe të shërbehen me libra. Ndërsa nga ora 16:30 deri në 19:45, ambientet e bibliotekës janë të hapura për studim dhe lexim, por shërbimi i librave për t'u marrë me vete nuk ofrohet gjatë këtij intervali. <i>Ev. A.1.25 Rregullore e Bibliotekës.pdf</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Gjatë vlerësimit, GVJ vë në dukje se pasurimi i vazhdueshëm i fondit të bibliotekës dhe rritja e aksesit në burimet online janë pjesë e politikave të institucionit. Departamenti bashkëpunon me përgjegjësin e bibliotekës për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe për të adresuar nevojat e studentëve. Institucioni përgatit çdo vit një listë të detajuar me literaturën e nevojshme për bibliotekën, duke u bazuar në propozimet dhe kërkesat e departamenteve. Institucioni ka nxitur krijimin e klubit "Books and Tech", i cili zhvillon aktivitete për të nxitur pasionin për librat dhe për të diskutuar sfidat që sjell dixhitalizimi. Iniciativë që të angazhojë studentët në një botë ku teknologjia po zhvillohet me shpejtësi. <i>Ev. A.2.9 Literatura në Bibliotekë për Shkencat Mjekësore.pdf</i> <i>Ev. A.2.14 Kërkesë për Përditësimin e Fondit të Librave për Vitin Akademik të Ri.pdf</i> <i>Ev. A.1.25 Rregullore e Bibliotekës.pdf</i>
Konkluzione	<i>Pasurimi i vazhdueshëm i fondit të bibliotekës dhe rritja e aksesit në burimet online janë të integruara në politikat institucionale. Gjithsesi, ashtu sic kemi rekomanduar, duhen</i>

	<u>nxitur përditësimet e titujve më tepër dhe botimi i cikleve të leksionit nga pedagogët.</u> <i>Bashkëpunimi i ngushtë mes departamenteve dhe përgjegjëses së bibliotekës kontribuon në përmirësimin e shërbimeve. Institucioni harton rregullisht lista të përditësuara të titujve, duke reflektuar nevojat e programit të studimit, dhe duke siguruar që biblioteka mbetet një burim i vlefshëm për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni disponon një sistem të avancuar për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët dhe aktivitetet e tyre, duke mbuluar procesin nga regjistrimi deri në diplomim. Ky sistem përfshin mjete si Portali Studentor dhe SIS Cluster, të cilat sigurojnë ruajtjen dhe administrimin e të dhënave studentore, përpunimin e informacionit akademik dhe prodhimin e raporteve statistikore. Sistemi gjithashtu menaxhon aspektet e tjera të funksionimit të universitetit, si financat studentore dhe aktivitetet e bibliotekës. Portali Studentor është një komponent kyç, pasi ofron akses në informacionin personal të studentëve, regjistrimin e notave dhe rezultatet e provimeve gjatë viteve të studimit. Për më tepër, institucioni ofron një udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, duke lehtësuar kështu navigimin dhe përdorimin e burimeve të ofruara. <i>Ev. A.1.12 Intraneti.pdf,</i> <i>Ev. A.1.12.1 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf</i>

Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ vëren se sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin dhe dokumentacionin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ky sistem përfshin Departamentin e Burimeve Njerëzore, Sekretarinë e Përgjithshme, sekretaritë mësimore, Bordet e Karrierës dhe Zyra e Menaxhimit të Logjistikës. Përmes bashkëpunimit ndërmjet këtyre njësive, realizohen proceset e domosdoshme për administrimin efikas të institucionit. Sistemi rregullon aktivitete si përgatitja e orareve, kontratat e punës dhe matja e performancës. <i>Ev. A.1.12 Intraneti.pdf,</i> <i>Ev. A.1.12.1 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, kanë qasje në informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm sipas statusit të tyre. Të drejtat e kërkesës për dokumente dhe informacion janë të garantuara për të gjithë, duke përfshirë vërtetime, lista notash dhe informacion mbi gjendjen e pagesave vjetore. <i>Ev. A.1.12 Intraneti.pdf,</i> <i>Ev. A.1.12.1 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Universiteti Barleti ka implementuar platformën Portal Studentor që nga viti 2016 për të digjitalizuar procesin e mësimdhënies. Ajo ofron akses në syllabuse, materiale studimi, provime dhe njoftime, duke siguruar gjithashtu auditimin e aktivitetit akademik dhe studentor. <i>Ev. A.1.12 Intraneti.pdf,</i> <i>Ev. A.1.12.1 Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa.pdf</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ thekson se Institucioni përdor sistemin e menaxhimit Intranet si një mjet efikas për të lejuar monitorimin e vazhdueshëm të proceseve akademike dhe administrative, duke ofruar të dhëna reale dhe të përditësuara. Njekohësisht mundëson auditimin në kohë reale të aktiviteteve gjatë vitit akademik dhe përtej tij. <i>Ev. A.1.12 Intraneti.pdf,</i>

Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare e Universitetit Barleti, e cila gjendet në www.umb.edu.al , ofron informacion të detajuar mbi filozofinë, misionin, partnerët dhe strukturën e institucioni. Ajo përfshin gjithashtu programet akademike dhe profile të hollësishme të stafit. Universiteti përdor edhe platforma sociale si Facebook dhe Instagram për të promovuar aktivitetet e tij. Faqja është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze. https://www.umb.edu.al/ https://fshm.umb.edu.al/			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se ky standard "Përmbushet plotësisht", pasi institucioni disponon një sistem të avancuar për menaxhimin e informacionit lidhur me studentët, duke mbuluar të gjitha fazat nga regjistrimi deri në diplomim. Me mjete si Portali Studentor dhe SIS Classter, sigurohet ruajtja dhe administrimi i të dhënave studentore dhe informacionit akademik. Sistemi menaxhon gjithashtu aspekte të tjera, si financat dhe aktivitetet e bibliotekës.</i> <i>Përveç kësaj, platforma Portal Studentor ofron qasje në syllabuse dhe materiale studimi, duke lehtësuar digjitalizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, sistemi Intranet lejon monitorimin e vazhdueshëm të aktiviteteve, ndërsa faqja zyrtare e universitetit ofron informacion të detajuar dhe është e aksesueshme në dy gjuhë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për	GVJ bazuar në Raportin e audituesit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale 2022/2023 vëren se institucioni përgatit çdo vit raportin financiar të detajuar për kostot e njësisë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe një plan për mbështetje financiare të nevojshme për realizimin e programeve për një cikël të plotë studimi. Ky raport bazohet në historikun e kostove, numrin e studentëve dhe stafit

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	akademik, duke analizuar raportin tarifë-shpenzime. Gjithashtu, institucioni disponon një fond rezervë emergjence për të garantuar vazhdimësinë e studimeve. Kjo tregon një stabilitet financiar dhe një monitorim rigoroz të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke mundësuar ndërhyrje të shpejta kur është e nevojshme. <i>Ev. A.1.26 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2022.pdf,</i> <i>Ev. A.1.27 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2023.pdf,</i> <i>Ev. A.1.28 Burimet financiare në dispozicion të strukturave 2023-2026.pdf</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ bazuar në Planin e financimit për programin e studimit “bachelor” Infermieri vëren se plani i financimit hartohet në nivel institucional dhe për çdo program studimi, duke përfshirë të gjitha kostot dhe të ardhurat e nevojshme, duke përmblusur me korrektësi aspektet e planit të financimit, duke siguruar një administrim të përgjegjshëm që mbështet ecurinë e mbarëvajtjes së programit. Shihet se respektohen në kohë të gjitha detyrimet kontraktuale, për të garantuar kështu stabilitet te programeve të studimit. <i>Ev. A.3.16 Plan financimi për programin e studimit Bachelor në Infermieri.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ bazuar në Raportin e audituesit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale 2022/2023 vëren se "Barleti Group" realizon çdo vit auditimin e pasqyrave financiare, duke përfshirë pasqyrën e pozicionit financiar, performancën, ndryshimet në kapital dhe flukset monetare. Ky auditim kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditori ligjor i pavarur ofron opinionin e tij mbi pozicionin financiar dhe performancën, duke siguruar që pasqyrat financiare të reflektojnë saktësisht situatën e shoqërisë në 31

	Dhjetor dhe operacionet për vitin e mbyllur, duke u përputhur me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. <i>Ev. A.1.26 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2022.pdf,</i> <i>Ev. A.1.27 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2023.pdf,</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ bazuar në Raportin e audituesit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale 2022/2023 cilëson se institucioni ka një plan zhvillimi të qëndrueshëm, i cili është i integruar në strategjinë institucionale. Në përfundim të çdo cikli të plotë studimi, institucioni harton raporte financiare për tri vitet e kaluara akademike. Këto raporte identifikojnë dhe planifikojnë nevojat për ndërhyrje specifike, duke synuar diversifikimin e financimit të programit dhe përmirësimin e ecurisë së tij në të ardhmen. Ato evidentojnë rezultatet dhe efektet e financimit, si dhe pritshmëritë për mënyrën e financimit, duke përfshirë parashikimet për vazhdimësinë e programit, me qëllim rritjen e standardeve dhe një interesim më të lartë nga të interesuarit. <i>Ev. A.1.26 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2022.pdf,</i> <i>Ev. A.1.27 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2023.pdf,</i> <i>Ev. A.1.28 Burimet financiare në dispozicion të strukturave 2023-2026.pdf</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Përmes pasqyrave financiare, institucioni demonstroi se ka siguruar të ardhurat e nevojshme për të ruajtur stabilitetin financiar dhe kapacitetet e kërkuara për të ardhmen. Burimet kryesore të financimit përfshijnë tarifat e studentëve, projekte dhe donacione. Këto pasqyra ofrojnë informacion të detajuar mbi secilën kategori të të ardhurave dhe shpenzimeve, duke treguar një rritje të qëndrueshme të të ardhurave gjatë viteve. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit, duke disponuar kapacitete të mjaftueshme për funksionimin normal të tyre. Nëse ndodhin nevoja për përmirësim financiar, institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe shqyrton mundësitë për diversifikimin e burimeve të financimit për programet e studimeve. <i>Ev. A.1.26 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2022.pdf,</i>

	Ev. A.1.27 Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale 2023.pdf, Ev. A.1.28 Burimet financiare në dispozicion të strukturave 2023-2026.pdf, Ev. A.3.16 Plan financimi për programin e studimit Bachelor në Infermieri.pdf			
Konkluzione	GVJ mendon se ky standard "Përmbushet plotësisht", pasi institucioni siguron çdo vit raportin financiar të detajuar për kostot e njësisë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe planin për mbështetje financiare për realizimin e programeve për një cikël të plotë studimi. Institucioni gjithashtu ka një plan zhvillimi të qëndrueshëm, i integruar në strategjinë institucionale, që përfshin hartimin e raporteve financiare për tri vitet e kaluara akademike. Këto raporte identifikojnë nevojat për ndërhyrje specifike dhe synojnë diversifikimin e financimit të programit. Pasqyrat financiare tregojnë një rritje të qëndrueshme të të ardhurave dhe garantimin e kapaciteteve të nevojshme financiare për zhvillimin e programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në	GVJ konstaton se institucionin ka implementuar politika dhe procedura të plota që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, nga regjistrimi deri në diplomim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e tij. Në shërbim të studentëve, përveç departamentit dhe sekretarisë mësimore,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti ofron Zyrën e Dekanit të Studentëve dhe struktura të tjera si Senati Akademik dhe Këshilli i Etikës dhe Shanseve të Barabarta. Këto organe ndihmojnë në përfshirjen dhe mbështetjen të studentëve, duke garantuar një ambient akademik të drejtë dhe të aksesueshëm. <i>Vizita në institucion.</i> <i>Ev. A.1.30 Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa,</i> <i>Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat e pranimi dhe përfundimit të studimeve në UniBa janë të ndërtuara mbi parimin e barazisë dhe garantimit të të drejtave të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët. Sipas Rregullores së Universitetit Barleti (Ev. A.1.3) dhe Rregullores së DSHMT (Ev. A.2.3), kriteret e pranimi, procedurat akademike dhe standardet e përfundimit të programit të studimit janë të qarta, transparente dhe të aksesueshme nga të gjithë. Këto rregullore sigurojnë që çdo student të trajtohet në mënyrë të barabartë, duke eliminuar çdo lloj diskriminimi dhe duke ofruar mundësi të njëjta për përparim akademik dhe profesional. Për më tepër, transparenca në zbatimin e këtyre procedurave garantohej përmes publikimeve dhe njoftimeve zyrtare, duke përfshirë informacion mbi kriteret e pranimi, ecurinë akademike dhe përfundimin e studimeve.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve që aplikojnë për programet e studimit, duke bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse të Maturës Shtetërore në përputhje me ligjin dhe udhëzimet përkatëse. Këto kriteret përfshijnë edhe procedurat për regjistrimin e studentëve të huaj. Pranimi dhe transferimi i studentëve kryhet në mënyrë transparente, duke u bazuar në kriteret të qarta dhe të aksesueshme publikisht. Informacioni mbi procedurat e aplikimit, regjistrimit dhe transferimeve është i disponueshëm në faqen zyrtare të UniBa, si dhe në komunikimet me zyrat përkatëse të institucionit. <i>Ev. A.1.13 - Manuali për rekrutim, aplikim, rregjistrim dhe transferim të studimeve për studentët</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të	Institucioni siguron që kriteret dhe procedurat për pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin akademik, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e

studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	dijeve dhe diplomimin të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të aksesueshme për publikun. Këto informacione janë të disponueshme në faqen zyrtare të universitetit, në aktet rregullatore dhe në intranetin e UniBa, duke garantuar transparencë të plotë. Gjithashtu, gjatë vizitave në institucion, të interesuarit mund të marrin informacion të detajuar mbi procedurat e aplikimit dhe transferimeve. <i>Ev.A.1.13. Manual për rekrutim, aplikim, regjistrim dhe transferim studimesh.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Institucioni siguron transparencën dhe informimin e duhur për të interesuarit dhe kandidatët në lidhje me kriteret dhe kërkesat e pranimit përpara fillimit të çdo viti akademik. Politikat e përgjithshme dhe specifike të pranimit hartohen dhe publikohen në faqen zyrtare të UniBa, si dhe në portalin U-Albania, duke siguruar akses të lehtë për të gjithë të interesuarit. Departamentet përkatëse propozojnë kriteret e pranimit për çdo program studimi, të cilat miratohen nga Senati Akademik. Këto informacione përditësohen sipas udhëzimeve dhe VKM-ve përkatëse dhe janë të disponueshme në: - Sesionin "Kriteret e Pranimit" në U-Albania - Sesionin "Pranimet" në faqen zyrtare të UniBa - Manuali për rekrutim, aplikim, regjistrim dhe transferim studimesh (Ev. A.1.13)
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UniBa mbështetur në kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve rregullatore në fuqi, përpilon akte rregullatore për kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve përfshi kandidatët me aftësi të veçantë, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Kriteret e përgjithshme dhe specifike të regjistrimit publikohen dhe në portalin u-Albania. Tarifat favorizuese të programit janë inkurajuese për kategoritë e mësipërme që janë zakonisht dhe më të interesuara për programe që të integrojnë shpejt në tregun e punës. <i>Takimi me stafin drejtues.; https://umb.edu.al/program-studimi/bachelor/bsc-infermieri.html</i> <i>(Ev. A.1.13)Manuali për rekrutim, aplikim, regjistrim dhe transferim studimesh</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik	Institucioni publikon kriteret për pranimin e studentëve nga shtete të tjera, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore. Regjistrimi i shqiptarëve nga trojet dhe studentëve të huaj

kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	bëhet sipas udhëzimeve të MASR, pa kritere shtesë përveç atyre ligjore.			
	Ev.A.1.13. Manual për rekrutim, aplikim, rregjistrim dhe transferim studimesh.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UniBa ofron bursa të plota ose të pjesshme për studentët në nevojë dhe për programet prioritare, bazuar në aktet e brendshme dhe legjislacionin në fuqi. Llojet e bursave bëhen publike, ndërsa shqyrtimi dhe miratimi i tyre kryhet nga komisione ad hoc dhe Bordi i Administrimit. Nga ky program studimi nuk ka patur student qe kane fituar burse.			
	Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti, Neni 84. https://umb.edu.al/tarifa-dhe-bursa.html			
Konkluzione	Bazuar në gjetjet e evidentuara, UniBa ka ngritur dhe zbaton një sistem transparent dhe të aksesueshëm për sigurimin e cilësisë në programet e studimit. Politikat dhe procedurat për pranimin, përzgjedhjen dhe mbështetjen e studentëve janë të qarta, të publikuara dhe në përputhje me ligjin.			
	Gjithashtu, institucionit i ofron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët, duke përfshirë ata nga grupet e veçanta, dhe zbaton një sistem monitorimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Praktikrat e informimit dhe ndërgjegjësimin janë të dokumentuara dhe realizohen në mënyrë periodike.			
	Në përmbledhje, UniBa përmbush në një nivel të kënaqshëm standardet e kërkuara, duke garantuar transparencë, barazi dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit të ofruar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e	GVJ vlerëson se institucioni ka të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të detajuar në rregullore kriteret dhe procedurat për përparimin akademik të studentëve, duke përfshirë kalimin nga një vit në tjetrin. Këto rregulla ofrojnë një udhëzim të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	qartë për studentët mbi mundësitë dhe kushtet për avancimin në studime, duke garantuar transparencë dhe barazi për të gjithë studentët. <i>Ev. A.3.2. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Infermieri</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	GVJ vlerëson se institucioni ka të përcaktuara qartë në rregullore kriteret dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme dhe për transferimin e studimeve. Departamenti, në bashkëpunim me zyrën e pranimit të studentëve, ofron informacion të plotë për studentët në lidhje me procedurat për njohjen e krediteve dhe kalimin nëpërmjet transferimit, duke siguruar transparencë dhe mundësi të drejta për studentët. <i>Ev.A.1.16. Rregullore e brendshme për transferimet dhe rregjistrimet në programet e dyta.</i> <i>Ev. A.3.2. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Infermieri</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Institucioni ka të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Infermieri” kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve. Këto përfshijnë mënyrën e hyrjes në provim, zhvillimin e provimeve, komunikimin e vlerësimeve dhe dokumentimin e tyre, duke siguruar transparencë dhe qartësi për studentët në lidhje me procesin e vlerësimit. Gjithashtu, çdo fillim viti akademik, institucioni organizon ditë orientuese për studentët, duke siguruar mbështetje të plotë nga stafi akademik dhe strukturat mbështetëse për të siguruar një kuptim të plotë të procedurave dhe rregullave të vlerësimit. <i>Ev. A.3.2. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Infermieri</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Këto procedura janë të përcaktuara në Rregulloren e Universitetit (neni 62) dhe në Rregulloren e Programit të Studimit (nenet 22 dhe 23). Studentët mund të diplomohen përmes një provimi të përgjithshëm përfundimtar ose duke përgatitur një punim diplome (nota mesatare mbi 8).



	<i>Ev. A.3.2. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Infermieri.</i> <i>Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UniBa organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e studentëve të ardhshëm dhe të interesuarve për programin e studimit. Në kuadër të këshillimit të karrierës, Barleti zhvillon aktivitete si Open Days, ku maturantët mund të vizitojnë institucionin dhe të ndjekin orë mësimi, si dhe organizon Javën e Orientimit për studentët e rinj para fillimit të vitit akademik. Gjatë regjistrimit, grupet e pedagogëve ofrojnë informacion të detajuar mbi programet e studimit, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve. <i>Ev. A. 1. 17. Open Day Barleti</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka të përcaktuara në mënyrë të detajuar dhe të qartë në rregullore kriteret dhe procedurat për përparimin akademik, njohjen e kualifikimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe aftësive të studentëve, si dhe procedurat e diplomimit. Këto procedura janë të aksesueshme dhe të kuptueshme për studentët, duke siguruar transparencë dhe mundësi të barabarta për të gjithë. Institucioni ofron mbështetje dhe orientim të plotë për studentët përmes aktiviteteve si Open Days dhe Javën e Orientimit, duke garantuar një informacion të qartë dhe të hollësishëm gjatë gjithë periudhës të studimeve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën,	GVJ vlerëson se informacioni në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit është i disponueshëm për studentët përmes këshillimit të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	drejtpërdrejtë me stafin akademik në momentin e interesimit për programin e studimit, si dhe përmes kontakteve me Zyrën e Pranimeve, Zyrën e Dekanit të Studentëve dhe Koordinatorin Akademik të Departamentit. Këto mundësi ofrojnë mbështetje dhe informacion të detajuar për të siguruar që studentët janë të informuar plotësisht për programin e studimit dhe mundësitë e tij. <i>Ev. A.3.2. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Infermieri.</i> <i>Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ vlerëson se informacioni për programin e studimit, duke përfshirë lëndët dhe modulet, është i disponueshëm për studentët që në momentin e regjistrimit. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm në faqen zyrtare të Universitetit Barleti. Në fillim të çdo semestri, studentëve u ofrohet një program i detajuar i lëndëve që do të zhvillohen, ku përfshihen ngarkesa, temat për çdo javë, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, si dhe niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës. Ky informacion siguron transparencë dhe mbështetje të plotë për studentët në menaxhimin e studimeve të tyre. <i>Ev. A. 3.10. Plan mësimor</i> <i>Ev. A.3.11. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në Infermieri https://fshm.umb.edu.al/, https://ëëë.umb.edu.al/</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ vlerëson se institucioni i jep një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës. Kjo bëhet përmes Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, e cila bashkëpunon ngushtë me këshilluesit e karrierës në çdo fakultet/departament, duke ofruar mbështetje të diferencuar në varësi të nivelit të studimit. Gjithashtu, Bordi i Karrierës funksionon si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Aktivitetet e tjera përfshijnë organizimin e panairëve të punës dhe aktiviteteve me aktorë nga tregu i punës, si dhe dërgimin e njoftimeve tek studentët mbi mundësitë e punësimit. Këto veprime kontribuojnë në ofrimin e mundësive për studentët për t'u orientuar drejt mundësive profesionale dhe për të lidhur universitetin me kërkesat e tregut të punës. <i>Ev. A.2.12 Vendim për ngritjen e bordit të karrierës në FSHM.</i>



	<i>Ev. A. 1. 29. Plani strategjik 2020-2025 Alumni dhe Karriera</i> https://students.umb.edu.al/neës5650.htmlUniBa Ëork Fair https://students.umb.edu.al/neës5768.htmlTrajnim https://students.umb.edu.al/neës5774.htmlEvente takimi me biznese
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ vlerëson se institucioni siguron informacion të plotë dhe të përditësuar për studentët në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse të përcaktuara në rregulloren e Institucionit dhe të DSHMT. Ky informacion u vihet në dispozicion studentëve që në momentin e regjistrimit, duke përfshirë detaje mbi programin e studimit dhe lëndët/modulet e tij. Koordinatorja e departamentit është në kontakt të rregullt me studentët përmes njoftimeve mbi infrastrukturën, aktivitete të ndryshme, oraret dhe informacione të tjera të rëndësishme për procesin mësimor. <i>Ev. A.2.3. Rregullore DSHMT.</i> <i>Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni ka vendosur një sërë mekanizmesh për të siguruar që informacioni mbi programin e studimit të jetë lehtësisht i arritshëm për studentët, edhe në distancë. Informacioni i detajuar mbi programin e studimit, lëndët përbërëse të tij, kreditet dhe struktura e tyre bëhet i disponueshëm përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit. Studentët gjithashtu njoftohen me programet lëndore (syllabuset) në fillim të çdo semestri, ku janë të përcaktuara në detaje temat, literaturat kryesore dhe të rekomanduara, format e kontrollit të dijeve dhe niveli i frekuentimit të lëndëve. Ky informacion është gjithashtu i disponueshëm në platformën Google Classroom, ku studentët mund të shohin materialet përkatëse për çdo javë dhe materialet e temave të leksioneve në PPT. Po ashtu, studentët janë të pajisur me adresë personale të postës elektronike @umb.edu.al, dhe përmes portalit studentor mund të kenë akses në rezultatet e provimeve dhe informacionet e tjera të rëndësishme online. <i>Ev. A.2.3. Rregullore DSHMT. Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti</i> <i>Ev.A.1.12.1. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit UniBa.</i>

	<i>Ev.A.1.15. Manual i përdorimit të portalit studentor.</i> <i>Ev.A. 1.32. Udhëzues për metodat e mësimdhënies.</i> <i>Ev. A. 1.32.1. Manual i mësimdhënies Online.</i> <i>Ev. A. 1.32.2. Guidë instruktive e mësimi Online</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standarti Përbushet plotësisht pasi informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit është i disponueshëm për studentët përmes kanaleve të ndryshme, si këshillimi me stafin akademik dhe kontaktet me Zyrën e Pranimeve dhe Koordinatorin Akademik. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm në faqen zyrtare dhe në fillim të çdo semestri, ku studentët marrin të dhëna të detajuara mbi lëndët dhe vlerësimin. Institucioni ofron mbështetje për orientimin në tregun e punës përmes Zyrës së Alumnit dhe Karrierës dhe aktiviteteve të tjera. Po ashtu, informacioni mësimor dhe administrativ është i aksesueshëm në platformën Google Classroom dhe sistemin e menaxhimit të brendshëm, duke siguruar akses të plotë për studentët.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ vlerëson se institucioni mban statistika të detajuara dhe të përditësuara për numrin e studentëve në secilin program studimi të cilat evidentuan gjatë vizitës në sekretarinë mësimore. Të dhënat përfshijnë cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe cdo informacion mbi punësimin gjatë dhe pas diplomimit. <i>Vizita në institucion. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e	GVJ gjatë vizitës së bere në sekretarinë mësimore vlerëson se institucioni administron dhe ruan statistika të plota mbi numrin e studentëve të regjistruar, transferimet, çregjistrimet dhe kalueshmërinë, deri në diplomim. Të dhënat përfshijnë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje. Përpunimi dhe analizimi i këtyre të dhënave bëhet në çdo kohë, duke përfshirë të gjithë brezat e studentëve që nga viti i parë akademik i Universitetit Barleti. Numri i studentëve të rregjistruar për herë të parë ndër vite është si më poshtë: - 2022-2023....36 Studentë; - 2023-2024 37 Studentë; - 2024-2025 35 Studentë; <i>Vizita në institucion. Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve.</i> <i>Ev. A.1.19. Rregullore për funksionin e sekretarive</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ vlerëson se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit nga Sekretaria Mësimore, duke garantuar siguri dhe verifikueshmëri për personat e autorizuar. Portali studentor ofron akses të menjëhershëm për studentët mbi notat, rezultatet e provimeve dhe informacione të tjera akademike. Këto të dhëna përpunohen dhe vihen në dispozicion të Dekanit dhe Përgjegjësit të Departamentit sipas kërkesës. <i>Vizita në institucion. Ev. A.1.19. Rregullore për funksionin e sekretarive</i> <i>Ev. A.1.15 - Manuali i përdorimit të portalit Studentor.</i> <i>Ev. A.1.12.1 - Udhëzues për përdorimin e strukturës së teknologjisë së informacionit UniBa</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me	Universiteti Barleti ka përcaktuar mekanizma për ushtrimin e kontroleve periodike mbi njësitë përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave studentore. Këto kontrole sigurojnë saktësinë dhe përditësimin e informacionit dhe dokumentacionit përkatës. Zv. Rektori për çështjet akademike udhëheq këtë proces, duke garantuar përputhshmërinë me misionin dhe vizionin e universitetit. <i>Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti</i>



veprimtarinë e tyre përkatëse.				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Në bazë të evidencave të vendosura në dispozicion, GVJ vëren se Institucioni realizon raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe shkallën e punësimit të tyre. Ky informacion shërben për analizën vjetore të institucionit dhe departamenteve, duke ndihmuar në vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe përcaktimin e masave për përmirësim. Gjithashtu, Departamenti në bashkëpunim me Zyrën Alumni dhe Karriera mban kontakte të rregullta me të diplomuarit për të ndjekur ecurinë e tyre profesionale dhe për t'i mbështetur me kualifikime të mëtejshme apo mundësi punësimi. <i>Ev. A.1.39 - Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa 2023 2024.</i> <i>Ev. A.2.2 Raport vjetor i departamentit 2022 2023.</i> <i>Ev. A.3.17 - Kalueshmëria e studentëve 2022 2024.</i> <i>Ev. A.2.2.1 Raport vjetor i departamentit 2023 2024.</i> <i>Ev. A.2.17 - Raporti i kërkimit shkencor 2022 2023;2023 2024 DSHMT</i>			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standarti Përmbushet plotësisht pasi institucioni mbledh dhe përditëson rregullisht të dhëna mbi studentët nga pranimi deri në diplomim, si dhe mbi punësimin e tyre. Statistikat vjetore për regjistrimet, diplomimet dhe transferimet menaxhohen në një sistem të sigurt dhe të verifikueshëm.</i> <i>Kontrollet periodike sigurojnë saktësinë e informacionit, ndërsa raportet analitike vjetore ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe punësueshmërisë së studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ vlerëson se institucioni i ka krijuar kushtet e nevojshme për angazhimin dhe përfaqësimin e studentëve në jetën akademike e institucionale, në përputhje me aktet ligjore dhe rregullat e brendshme të tij. Institucioni ka ngritur njësi të dedikuara për informimin dhe mbështetjen e studentëve, duke mundësuar përfaqësimin e tyre në organet drejtuese, strukturat mësimore-kërkimore dhe ato të shërbimeve. Universiteti inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e lirë të studentëve në proceset vendimmarrëse dhe në shprehjen e mendimeve të tyre. Ndër organet kryesore ku studentët marrin pjesë aktivisht, përmenden: • Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Standardeve të Cilësisë; • Dekanati i Fakultetit; • Qeveria e Studentëve; • Senati Akademik. <i>Ev. A.2.13 - Mbledhje departamenti DSHMT;</i> <i>Ev. A.1.41 - Strategji e klubeve studentore 2024 2030;</i> <i>Ev. A.1.21 - Rregullore për Organizimin e Zgjedhjeve në Qeverinë Studentore;</i> <i>Ev. A.1.3 - Rregullore e Universitetit "Barleti";</i> <i>Ev. A.1.1 - Statuti i Universitetit "Barleti";</i> <i>Ev. A.1.29 - Plani Strategjik 2020 - 2025 Alumni dhe Karriera.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se në takimet me studentët dhe nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, u vërejt se institucioni garanton një përfshirje reale, konkrete dhe të matshme të studentëve në procesin e vlerësimit akademik. Përpara përfundimit të çdo semestri, studentët realizojnë vlerësimin anonim të pedagogëve përmes një pyetësoi elektronik, i cili përfshin pyetje mbi cilësinë e mësimdhënies, literaturës së përdorur, si dhe gatishmërinë e pedagogëve për t'i mbështetur në përmbushjen e detyrimeve të lëndës dhe në sqarimin e rezultateve të tyre. Gjithashtu, departamentet zhvillojnë takime të hapura me pedagogë dhe studentë, ku diskutohen problematika dhe përmirësime të mundshme. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente analizohen në nivel drejtues të institucionit për të marrë masa konkrete për përmirësimin e cilësisë.



	Vlen të përmendet gjithashtu se një student i programit BA në Infermieri është përfshirë drejtpërdrejt si anëtar i GVJ-së të ngritur për hartimin e këtij raporti. <i>Vizita në institucion, takimi me studentët dhe Dekanin e Studentëve.</i> <i>Ev. A.2.6 - Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i I;</i> <i>Ev. A.2.6.1 Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i II.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ gjatë takimit me studentët u informua që përfshirja e tyre është aktive dhe mendimi i tyre merret rregullisht përmes pyetësorëve dhe fokus grupeve, sidomos për nevojat e përmirësimit ose përshtatjes së programeve të studimit. Institucioni ka treguar vëmendje të vazhdueshme ndaj propozimeve të studentëve, duke reflektuar konkretisht sugjerimet dhe kontributin e studentëve. Gjithsesi ky është një program që akreditohet për herë të parë kështuqë për ndryshimet eventuale duhet të pritët akreditimi i parë. <i>Ev. A.1.40 – Guidë për fokus grupe;</i> <i>Ev. A.2.6 Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I;</i> <i>Ev. A.2.6.1 Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri II</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ konstaton se ashtu siç është theksuar edhe më sipër, studentëve u garantohej e drejta të shprehin mendimin e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit, si dhe të përdorin mekanizmat e ankimimit, rishikimit dhe reflektimit institucional. Procesi i kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është i qartë dhe transparent, i përcaktuar në rregulloren e programit të studimit dhe të detajuar në syllabus-in e çdo lënde. Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me studentët dhe zyrat përkatëse, u vërejt se studentët janë të përfshirë aktivisht në vlerësimin periodik të metodave dhe formave të mësimdhënies. Ata mund të japin mendimet e tyre përmes pyetësorëve dy herë në vit, pas çdo semestri, duke vlerësuar lëndën, mënyrën e transmetimit të dijeve, literaturën dhe kontrollin e dijeve. Po ashtu, studentët kanë mundësinë të shprehin opinione të lira për përmirësime në këto procese. Pjesë e këtij procesi është gjithashtu mundësia për ankimim në

	rast të shkeljeve të rregullave të provimit dhe për rezultatit përfundimtar të provimeve <i>Ev. A.3.2. Rregullore e programit të studimit Bachelor në Infermieri;</i> <i>Ev. A.2.6 Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri I;</i> <i>Ev. A.2.6.1 Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri II</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka vendosur mekanizma të qartë dhe funksionalë që garantojnë përfshirjen aktive të studentëve, transparencën dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit, si dhe reflektimin e vazhdueshëm të mendimeve e propozimeve të tyre në përmirësimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ vëren se Institucioni ka ngritur një sërë procedurash dhe njësi të posaçme për shërbimin e studentëve, të cilat janë të lehtësisht të arritshme për studentët dhe veprojnë në mënyrë të përhershme. Këto përfshijnë Zyrën e Pranimit, Sekretarinë Mësimore, Dekanin e Studentëve dhe Zyrën "Alumni dhe Karriera", të cilat mbështesin studentët në përputhje me ligjet dhe aktet rregullatore të institucionit. Dokumente kyçe që mbështesin implementimin e këtij procesi janë: Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë dhe Udhëzuesi për metodat e mësimdhënies. <i>Ev. A. 1.32. - Udhëzues për metodat e mësimdhënies.</i> <i>Evidenca A. 1.9 - Rregullore e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.</i>



	<i>Evidenca A. 1.10 - Rregullore e Njesisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.</i> <i>Ev.A.1.12.1.Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit UniBa.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik, a organizuar bashkëpunimin mes Njesisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, Zëvendës Rektorit për Çështjet Akademike, Zyra e Vlerësimit të Performancës dhe njësitë bazë, të cilat analizojnë të dhënat e mbledhura nga stafi dhe studentët për të identifikuar nevojat për përmirësime në proceset akademike dhe administrative. Dokumentet përkatëse, si Rregullorja për Vlerësimin e Performancës dhe formularët e vlerësimit, mbështesin këtë proces. <i>Ev. A. 1.35 - Formular vlerësimi i studentëve për lëndën .</i> <i>Ev.A.1.34. - Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performancës.</i> <i>Ev. A.1.36 - Format i raportimit të punës semestrale.</i> <i>Ev. A.1. 37.- Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve.</i> <i>Ev. A.2.16.- Formular vlerësimi të mësimdhënies kolege me kolege (peer evaluation of teaching)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	GVJ, gjatë vizitës në institucion, konstaton se institucioni ofron shërbime të strukturuar për këshillimin e karrierës përmes Zyrës “Alumni dhe Karriera” dhe Dekanit të Studentëve, në bashkëpunim me departamentet. Studentët marrin mbështetje për praktikën profesionale dhe orientimin në tregun e punës. Studentët udhëzohen për mundësitë e praktikës profesionale përmes koordinatorit të departamentit dhe pedagogut të caktuar, i cili mbikëqyr zhvillimin e kësaj lëndë të parashikuar në planin mësimor të programit. Gjithashtu, Klubi i Karrierës dhe rrjeti i strukturave të Grupit Barleti ofrojnë mundësi për zhvillim profesional dhe ndërveprim me punëdhënësit e ardhshëm. <i>Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti;</i> <i>Ev.A.1.30. Rregullore e funksionimit të Zyrave në Shërbim të Studentëve, pranë UniBa</i> <i>Ev. A. 3.8 Paketa e praktikave Profesionale.</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët	Zyra “Alumni dhe Karriera” në UniBa ndjek studentët pas diplomimit duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta dhe

pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	duke krijuar një bazë të dhënash mbi punësimin dhe vazhdimin e studimeve të të diplomuarve, si në UniBa ashtu edhe në institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Këto të dhëna mblidhen përmes komunikimeve të vazhdueshme me studentët përmes email-eve, telefonatave, pyetësorëve dhe rrjeteve sociale. Çdo vit, Zyra "Alumni dhe Karriera" harton raporte vjetore në lidhje me gjurmimin e studentëve të diplomuar dhe i vendos ato në dispozicion të organeve drejtuese të institucionit, sipas kërkesës.			
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se standardi përmbushet plotësisht pasi Institucioni ka ngritur njësi të posaçme për shërbimin e studentëve, të cilat janë të arritshme dhe veprojnë në mënyrë të përhershme.</i> <i>Këto përfshijnë Zyrën e Pranimi, Sekretarinë Mësimore, Dekanin e Studentëve dhe Zyrën "Alumni dhe Karriera". Gjithashtu, mekanizmat për monitorimin dhe vlerësimin e mësimdhënies dhe përfshirja e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies janë të qarta dhe efektive. Zyra "Alumni dhe Karriera" ndjek studentët pas diplomimit dhe mban të dhëna mbi punësimin dhe vazhdimin e studimeve të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin	GVJ, pas vizitës në institucion dhe takimeve me stafin akademik, si dhe shqyrtimit të rregulloreve dhe udhëzuesve në dispozicion për metodat e mësimdhënies, konstaton se

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	institucioni zbaton politika dhe procedura të qarta për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Masa këto që synojnë garantimin e standardeve akademike, edhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Për këtë qëllim, janë hartuar dokumente që rregullojnë dhe mbështesin procesin akademik, si: • Rregulloren për funksionimin e Komisionit të Sigurimit të Cilësisë, • Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, • Udhëzuesin mbi metodat e mësimdhënies. Këto dokumente dhe praktika demonstrojnë një angazhim të institucionit për të garantuar një mësimdhënie cilësore dhe për të mbështetur stafin akademik në zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies. <i>Evidenca A. 1.9 - Rregullore e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë.</i> <i>Evidenca A. 1.10 - Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.</i> <i>Ev.A.1.12.1. Udhëzues për përdorimin e Strukturës së Teknologjisë së Informacionit UniBa..</i> <i>Ev. A. 1.32. - Udhëzues për metodat e mësimdhënies</i> <i>Ev. A. 1.32.1. Manual i mësimdhënies Online</i> <i>Ev. A. 1.32.2. Guidë instruktive e mësimi Online</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se institucioni ka në përbërjen e tij mekanizma të dedikuar për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, si: • Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC); • Zëvendës Rektori për Çështjet Akademike; • Zyra e Vlerësimit të Performancës; • Njësitë bazë dhe kryesore akademike; Këto struktura bashkëpunojnë në mënyrë të vazhdueshme për të monitoruar, analizuar dhe vlerësuar procesin e mësimdhënies së personelit akademik dhe ndihmësakademik. Nëpërmjet mbledhjes dhe shqyrtimit të të dhënave nga stafi akademik, ndihmësakademik dhe studentët, këto mekanizma

	identifikojnë nevojat për përmirësim si në proceset akademike ashtu edhe në ato administrative. <i>Ev.A.1.34. - Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës.</i> <i>Ev. A. 1.35 - Formular vleresimi i studentëve për lëndën.</i> <i>Ev. A.1.36 - Format i raportimit të punës semestrale.</i> <i>Ev. A.1. 37.- Formulari për transparencë të vlerësimit studentëve.</i> <i>Ev. A.2.16.- Formular vleresimi të mësimdhënies kolege me kolege (peer evaluation of teaching)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se institucioni ka vendosur mekanizma të qartë për përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies, si dhe të procesit të vlerësimit të dijeve. Studentët marrin pjesë në këto procese përmes pyetësorëve dhe grupeve të fokusit, ku japin mendimet e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies dhe vlerësimit akademik. Pyetësorët zhvillohen dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, duke u mundësuar studentëve të shprehin vlerësimet e tyre për lëndën, mënyrën e transmetimit të dijeve, literaturën dhe metodat e kontrollit të dijeve. Përveç vlerësimeve të strukturuar, studentët kanë mundësinë të japin komente dhe sugjerime të lira mbi procesin mësimor. Pas përfundimit të pyetësorëve, hartohet raporti përmbljedhës mbi vlerësimet e studentëve. Gjithashtu, institucioni ka një procedurë të qartë për trajtimin e ankesave të studentëve. Ata mund të ankimojnë shkeljet e rregullave të provimeve pranë drejtuesit të departamentit brenda 24 orëve nga zhvillimi i provimit. Për ankimet mbi rezultatet përfundimtare të provimeve, studentët kanë të drejtën të paraqesin kërkesën e tyre brenda 48 orëve nga momenti i shpalljes së notës. <i>Ev. A.1.3. Rregullore e Universitetit Barleti</i> <i>Ev. A. 1.35 - Formular vleresimi i studentëve për lëndën</i> <i>Ev. A. 2.6. Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri 1</i> <i>Ev. A. 2.6.1 Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri 2</i>

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pas vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bën publike rezultatet e vlerësimeve dhe i përdor ato për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit akademik. Në përfundim të vitit akademik, Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC) harton raportin vjetor mbi vlerësimin e cilësisë në institucion, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë akademike dhe procesit të mësimdhënies-nxënies. Një përmbledhje e raportit publikohet në faqen zyrtare të institucionit për transparencë dhe informim. Pas përfundimit të vlerësimit të studentëve për lëndët, NjZhKC përgatit një raport të detajuar mbi gjetjet dhe rezultatet e këtij procesi. Ky raport përcillet fillimisht në Rektoratin, i cili më pas e shpërndan drejtuesve të departamenteve. Në mënyrë konfidenciale, informacioni bëhet i ditur për stafin përkatës. Raportet e vlerësimeve shërbejnë si burim kryesor për zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe proceseve akademike në institucion. <i>Ev. A. 1.39 - Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se institucioni ka krijuar mekanizma efektivë për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe për të promovuar praktikat e mira akademike. Vlerësimi i performancës së stafit akademik zhvillohet dy herë në vit, në përfundim të secilit semestër, duke u bazuar në rregulloren për administrimin e performancës. Nëpërmjet rezultateve të këtyre vlerësimeve, institucioni merr masa për të motivuar dhe mbështetur stafin akademik. Disa nga mënyrat për stimulimin e personelit përfshijnë shpërblime financiare, mbështetje për kërkimin shkencor, financim për pjesëmarrje në konferenca, si dhe mundësi shkëmbimi akademik me universitete ndërkombëtare përmes programit Erasmus+. Këto iniciativa kontribuojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimin profesional të stafit akademik. <i>Ev. A. 1.34.- Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës</i>
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), pas analizës së dokumentacionit dhe vizitës në institucion, shprehet se institucioni ka krijuar dhe zbaton mekanizma të qartë për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Vlerësimi periodik i stafit akademik dhe përfshirja aktive e</i>

	<i>studentëve në proceset e vlerësimit sigurojnë një qasje të strukturuar dhe të vazhdueshme ndaj përmirësimit të cilësisë akademike.</i> <i>Institucioni garanton transparencë në publikimin e rezultateve të vlerësimeve dhe përdor gjetjet për të zhvilluar më tej praktikatat e mësimdhënies.</i> <i>Gjithashtu, nëpërmjet mbështetjes për kërkimin shkencor, shpërblimeve dhe mundësive për shkëmbim akademik, institucioni promovon praktikatat e mira dhe nxit zhvillimin profesional të stafit. Bazuar në këto gjetje, GVJ vlerëson se institucioni përmbush në një shkallë të kënaqshme standardin e kërkuar për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni ka zhvilluar politika dhe struktura të qarta për sigurimin e brendshëm të cilësisë, duke u siguruar që veprimtaria e tij të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet rregullatore dhe objektivat strategjike. Këto politika synojnë ruajtjen e standardeve akademike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procesit mësimor në përputhje me vizionin dhe misionin institucional. Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë përfshijnë Komisionin e Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë, si dhe Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, të cilat funksionojnë bazuar në rregulloret përkatëse dhe statutin e institucionit. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Performancës monitoron dhe analizon jo vetëm performancën e stafit akademik, por edhe aspekte të tjera si procesi akademik, kërkimi shkencor, çështjet studentore dhe marrëdhëniet me komunitetin, duke kontribuar në zhvillimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit.
	<i>Ev. A. 1.1. Statuti i Universitetit Barleti.</i> <i>Ev. A. 1.3. Rregullore e universitetit "Barleti".</i>

	<i>Evidenca A. 1.9 - Rregullore e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë.</i> <i>Evidenca A. 1.10 - Rregullore e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.</i> <i>Ev. A. 1.34.- Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës. https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Institucioni ka zhvilluar dhe mban në funksion një sistem të brendshëm të sigurimit të cilësisë, i cili është i lidhur ngushtë me strategjinë e përgjithshme institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky sistem përfshin struktura dhe grupe që bashkëpunojnë për të mbështetur objektivat e UniBa dhe strategjitë për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë studentët dhe ekspertë të jashtëm. Strategjia UniBa 2020-2030 përfshin disa qëllime kryesore, si përmirësimi i proceseve mësimore, përfshirja e modeleve të mësimdhënies të kombinuara (online dhe ballë për ballë), mbështetje për punësimin e të diplomuarve, përmirësimi i kurrikulave dhe pasurimi i bibliotekës, si dhe zhvillimi i strukturave menaxhuese dhe ndërkombëtarizimi. Një bashkëpunim i ngushtë zhvillohet ndërmjet Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC), Zyrës së Alumnit dhe Karrierës, Zyrës së Pranimeve, dhe njësive të tjera për të lidhur studentët dhe alumni me institucionin, duke përfshirë gjithashtu bashkëpunimin me ekspertë të jashtëm. Ky bashkëpunim është një komponent kyç në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe siguron që programet e studimit të përputhen me kërkesat e tregut të punës. <i>Ev. A. 1.2. Strategjia e zhvillimit të institucional 2020-2030.</i> <i>Ev. A.1.30. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.</i> <i>Ev. A. 3. 7 - Marrëveshje Bashkëpunimi në funksion të programit të studimit.</i> <i>Ev. A.1.2.1 Strategjia e ndërkombëtarizimit të UniBa</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit,	Institucioni përdor një sërë instrumentesh për sigurimin e cilësisë në proceset e mësimdhënies dhe programeve të studimit. Përfshihet një set i instrumenteve të brendshme, si formularët e vlerësimit të studentëve për lëndët, të cilët mbledhin të dhëna anonime dhe përmes të cilave hartohet një raport që siguron transparencën e procesit të vlerësimit. Po ashtu, realizohet një vlerësim i kolegëve, duke kontribuar në zhvillimin e mësimdhënies dhe rritjen e cilësisë.

vlërësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Në këtë kuadër, UniBa përdor instrumente të rëndësishme për akreditimin dhe riakreditimin e programeve, duke siguruar që proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të kërkuara.			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni ka vendosur indikatorë të matshëm dhe të qartë për të vlerësuar performancën në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, të cilët ndihmojnë në identifikimin e arritjeve dhe fushave që kërkojnë përmirësim. Çdo anëtar i stafit të plotë paraqet një raport të detajuar në fund të çdo semestri, ku pasqyrohen aktivitetet e tij, përfshirë mësimdhënien, trajnimet, projektet, kërkimin shkencor dhe angazhimet administrative. Përveç raportimeve nga vetë stafi, sekretaria gjithashtu siguron të dhëna mbi orët e realizuara dhe monitorimin e mësimin dhe provimeve. Në bazë të këtyre informacioneve, institucioni përdor mekanizma për të inkurajuar dhe promovuar arritjet e mira, duke përfshirë emërime në pozita të veçanta dhe mbështetje financiare për aktivitete kërkimore. Këto vlerësime dhe promovime pasqyrohen në raportet vjetore të institucionit dhe diskutohen në mbledhjet e departamentit për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike. <i>Ev. A.1.36 - Format i raportimit të punës semestrale.</i> <i>Ev. A.1.22 - Manuali i menaxhimit të Burimeve Njerëzore.</i> <i>Ev. A.1.34 - Rregullore për Vlerësimin dhe Administrimin e Performacës.</i> <i>Ev. A.1.39 - Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa 2023 2024</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka zhvilluar dhe implementuar politika dhe struktura të qarta për sigurimin e cilësisë, në përputhje me legjislacionin dhe objektivat strategjikë. Struktura përgjegjëse për cilësinë, si Komisioni i Sigurimit të Standardeve dhe Njësia e Zhvillimit Kurrikular, funksionojnë sipas rregulloreve të institucionit.</i> <i>Sistemi i brendshëm i cilësisë është i lidhur ngushtë me strategjinë institucionale dhe përfshin bashkëpunim me studentë, alumni dhe ekspertë të jashtëm. Instrumentet e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë janë të integruara dhe sigurojnë përmirësimin e vazhdueshëm. Kriteri është plotësisht i përmbushur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënëit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Institucioni përdor procedura të miratuara dhe të dokumentuara për të monitoruar dhe vlerësuar rregullisht programet e studimit të ciklit të parë, për të siguruar përmbushjen e standardeve të akreditimit. Ky proces përfshin identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta, si dhe formulimin e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Në Universitetin “Barleti”, programi i studimit Bachelor në “Infermieri” shqyrtohet dhe mbikëqyret rregullisht përmes vlerësimeve të brendshme dhe analizave nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë. Këto vlerësime dokumentohen dhe bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse për të siguruar përmirësime të vazhdueshme. Raportet vjetore të Departamentit të Shkencave Mjekësore-Teknike, që mbikëqyrin këtë program, paraqesin informacionin dhe rekomandimet për të përmirësuar proceset mësimore dhe kërkimore. <i>Ev. A.2.2 - Raport vjetor i departamentit 2022 2023.</i> <i>Ev. A.2.2.1 - Raport vjetor i departamentit 2023 2024.</i> <i>Ev. A.2.6 - Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023- 2024, semestri i I.</i> <i>Ev. A.2.6.1 - Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i II</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në	Nga evidencat rezultojnë se Institucioni ka të krijuar Njësine e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë (NjZhKC) e cila bën një vlerësim të rregullt të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore, duke përpiluar raporte vjetore mbi cilësinë. Këto raporte përfshijnë një analizë të rezultateve të pritshme dhe atyre të vlerësuar, duke evidentuar arritjet më të shquara dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ato gjithashtu ndihmojnë në promovimin e praktikave të mira dhe arritjeve të rëndësishme nga stafi akademik dhe studentët. NjZhKC përgatit një raport të vlerësimit të studentëve, i cili dërgohet në Zyrën e Vlerësimit të Performancës për të inkurajuar praktikat dhe arritjet më të mira.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	<i>Ev. A.1.39 - Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa 2023 2024.</i> <i>Ev. A.2.6 - Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i I.</i> <i>Ev. A.2.6.1 - Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i II</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga të dhënat e institucionit dhe vizita në institucion me stafin dhe studentët, vërehet se për të siguruar cilësinë dhe ecurinë e programit të studimit, përdoren metoda të ndryshme vlerësimi si: • Raportet semestrale të pedagogëve mbi aktivitetet e kryera; • Vlerësimi i studentëve në fund të secilit semestër nga NjZHKC; • Grumbullimi i mendimeve përmes fokus grupeve; • Vëzhgimi i aktivitetit të studentëve në auditor; • Analiza e rezultateve të provimeve; • Miratimi i tezave të provimeve nga udhëheqësit e departamenteve; • Takime mujore për diskutimin e progresit të mësimdhënies dhe procesit akademik në departament; Këto metoda janë të dokumentuara dhe implementohen për të monitoruar dhe përmirësuar cilësinë e programeve të studimit. <i>Ev. A.1.36 - Format i raportimit të punës semestrale.</i> <i>Ev. A.1.35 - Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.</i> <i>Ev. A.2.16 - Formular vlerësimi të mësimdhënies kolege me kolege (peer evaluation of teaching)</i> <i>Ev. A.1.37 - Formulari për transparencë të vlerësimit të studentëve.</i> <i>Ev. A.3.15 - Model teze provimi.</i> <i>Ev. A.1.40 - Guide për fokus grup.</i> <i>Ev. A.2.13 - Mbledhje departamenti DSHMT</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të	Sipas të dhënave të institucionit, për të monitoruar dhe vlerësuar cilësinë dhe funksionimin e programeve të studimit, përdoren edhe metoda indirekte si:


studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	• Sondazhe të studentëve të regjistruar në programet e studimit; • Anketat e Qeverisë studentore; • Pyetësorë për alumni; <i>Ev. A.1.36 - Format i raportimit të punës semestrale.</i> <i>Ev. A.1.35 - Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.</i> <i>Ev. A.2.16 - Formular vlerësimi të mësimdhënies kolege me kolege (peer evaluation of teaching)</i> <i>Ev. A.1.37 - Formulari për transparencë të vlerësimit të studentëve.</i> <i>Ev. A.3.15 - Model teze provimi.</i> <i>Ev. A.1.40 - Guide për fokus grup.</i> <i>Ev. A.2.13 - Mbledhje departamenti DSHMT</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mendon se Kriteri përmbushet plotësisht pasi institucioni ka vendosur procedura të miratuara dhe të dokumentuara për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Ky proces përfshin përdorimin e metodave të ndryshme vlerësimi, si raportet semestrale, vlerësimet e studentëve, vëzhgimet në auditor dhe analizat e rezultateve të provimeve, të cilat ndihmojnë në identifikimin e arritjeve dhe dobësive.</i> <i>Gjithashtu, institucionit i është mundësuar të zhvillojë masa për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke siguruar që proceset mësimore dhe kërkimore të përmirësohen në mënyrë të qëndrueshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni ka parashikuar përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. Konkretisht, në Komisionin e Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë (KSSC), është parashikuar përfshirja e një përfaqësuesi të studentëve, duke u siguruar kështu që mendimet e studentëve janë pjesë e procesit të vendimmarrjes. Përveç kësaj, studentët përfshihen në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit. UniBa gjithashtu ka një bashkëpunim të ngushtë me studentët alumni dhe përfaqësuesit e bizneseve, për të mbledhur mendime mbi ecurinë e programeve të studimit dhe për t'i përshtatur ato me kërkesat e tregut të punës. <i>Ev. A.1.2 -Strategjia e Zhvillimit Institucional.</i> <i>Ev. A.1.9 - Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.</i> <i>Ev. A.1.30 - Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa.</i> <i>Ev. A.1.29 - Plani Strategjik 2020 - 2025 Alumni dhe Karriera.</i> <i>Ev. A.3.7 - Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të programit të Studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ vëren se institucionit ka përcaktuar përgjegjësi dhe detyra të qarta për njësitë, individët, studentët dhe palët e tjera të angazhuara në sigurimin e cilësisë së programit të studimit dhe siguron ushtrimin e këtyre detyrave me përgjegjësi. Anëtarët e Komisionit të Sigurimit të Standardeve dhe Cilësisë dhe të Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë kanë përgjegjësi të ndryshme dhe të përshtatura me rolet e tyre, që specifikohen në rregulloret dhe planet e punës të institucionit. Për të siguruar ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, UniBa përdor indikatorë të ndryshëm si monitorimi i respektimit të Kalendarit Akademik dhe vlerësimi i pedagogëve nga studentët. Këta indikatorë përdoren për të siguruar përmirësime të vazhdueshme në standardet dhe cilësinë e ofruar. NjZHKC ka gjithashtu përgjegjësi në hartimin dhe menaxhimin e programeve të studimit, akreditimin e tyre, dhe përcaktimin e procedurave dhe standardeve për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë, duke mbajtur një lidhje të ngushtë me fakultetet përkatëse. <i>Ev. A.1.3 -Rregullore e Universitetit "Barleti".</i>



	<i>Ev. A.1.9 - Rregullorja e funksionimit të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.</i> <i>Ev. A.1.10 - Rregullorja e Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.</i> <i>Ev. A.1.38 - Plani i punës së Njësisë së Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë.</i> <i>Ev. A.1.18 - Kalendari akademik i UniBa (2022-2023/2023-2024/2024-2025).</i> <i>Ev. A.1.5 - Manuali i cilësisë</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni ka siguruar përfshirjen e të gjithë grupeve të interesuara në vlerësimin dhe garantimin e cilësisë së programit të studimit. Ky proces përfshin njësinë përgjegjëse për programin, personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët. Anëtarët e grupit të vlerësimit të brendshëm përfshijnë pedagogët që ofrojnë programin, stafin administrativ dhe studentët. <i>Vizita në institucion, takimi me stafin dhe studentët</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ vëren se përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit realizohen në përputhje me Kodin e Etikës dhe janë të orientuara për të garantuar integritetin akademik dhe për të shmangur çdo formë diskriminimi ose pabarazie ndaj personelit dhe studentëve. Statuti i Universitetit "Barleti", në nenin 3, pika 3, thekson se veprimtaritë e universitetit mbështeten në meritat personale dhe përjashtojnë çdo lloj diskriminimi. Ky angazhim siguron se proceset e vlerësimit janë të drejta dhe të barabarta për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik. <i>Ev. A.1.14 - Kodi i Etikës.</i> <i>Ev. A.1.33 Rregullore e Këshillit të Etikës dhe Shanseve të barabarta.</i> <i>Ev. A.1.1 - Statuti i Universitetit "Barleti"</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe	Institucioni ka siguruar përfshirjen e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së brendshme, duke i angazhuar ata në aktivitete të tilla si tryeza të rumbullakëta, mbledhje dhe bashkëpunime të tjera, si edhe ngritjen e Bordit të Karrierës në FSHM. Kjo siguron që

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	mendimet dhe ekspertiza e tyre të kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>Ev. A.3.7 - Marrëveshje bashkëpunimi në funksion të programit të</i> <i>Studimit. Ev. A.2.12 - Vendim për ngritjen e Bordit të Karrierës në FSHM</i>			
Konkluzione	GVJ konkludon se institucioni ka përmbushur plotësisht standardin për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë. Institucioni ka përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm, duke siguruar transparencë dhe përfshirje të gjithë palëve të interesuara në proceset e vlerësimit. <i>Përgjegjësitë dhe detyrat janë të qarta dhe të mirëpërcaktuara për të mbështetur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Indikatorët për monitorimin e ecurisë, si vlerësimi i pedagogëve dhe respektimi i Kalendarit Akademik, kontribuojnë në përmirësime të vazhdueshme.</i> <i>Pjesëmarrja e grupeve të interesuara, duke përfshirë pedagogët, studentët dhe ekspertët e jashtëm, garanton integritetin akademik dhe shmangien e diskriminimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni ka siguruar transparencë dhe publikim të politikave, strategjive, organizimit dhe veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programet e studimit. Këto janë publikuar dhe janë në dispozicion për studentët dhe të gjithë palët e interesuara në faqen e dedikuar për Sigurimin e Cilësisë si dhe në faqen zyrtare të Universitetit "Barleti". Kjo transparencë siguron akses të lehtë për të gjitha grupet e interesuara për të marrë informacion të detajuar mbi

	politikat dhe aktivitetet që mbështesin cilësinë e programeve të studimit. https://umb.edu.al/sigurimi-i-cilesise.html https://umb.edu.al/neës4901.html https://umb.edu.al/neës5125.html https://umb.edu.al/neës5030.html
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	GVJ vëren se institucioni ka siguruar transparencë në publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programeve të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe duke u përputhur me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Parimet mbi të cilat ndërtohet Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë janë të përcaktuara në Rregulloren e Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, duke garantuar transparencën dhe informimin e partnerëve dhe publikut të gjerë. Raporti vjetor i NjZhKC, që publikohet për vitin akademik 2023-2024, i jep mundësinë komunitetit të informohet mbi performancën e UniBa, duke respektuar gjithashtu etikën akademike dhe mbrojtjen e të dhënave personale. <i>Ev. A.1.39 - Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa 2023 2024</i> https://umb.edu.al/dossier-uniba.html
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ vëren se institucionit ka siguruar që rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit të shoqërohen me një plan masash për adresimin dhe përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Në raportin vjetor të NjZhKC, rekomandohen detyra konkrete për përmirësimin e veprimtarisë, të cilat ndjekin një proces monitorimi dhe zbatimi nga strukturat drejtuese të UniBa. Raporti përmban udhëzime për njësitë përkatëse lidhur me pikat e forta dhe të dobëta të programeve të studimit, ndërsa propozimet e bëra shqyrtohen dhe reflektohen në vendimmarrjen e autoriteteve drejtuese. Kjo qasje ka ndihmuar në shmangien e dobësive dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe standardeve të kërkuara për programin e studimit. <i>Ev. A.1.39 - Raport vjetor për vlerësimin e cilësisë në UniBa 2023 2024.</i> <i>Ev. A.1.35 - Formular vlerësimi i studentëve për lëndën.</i> <i>Ev. A.2.6 - Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i I.</i>

	<i>Ev. A.2.6.1 - Raporti i vlerësimit të studentëve për vitin akademik 2023-2024, semestri i II</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucionin ka një proces të vazhdueshëm dhe të strukturuar për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, i cili përfshin pasurimin e literaturës bazë dhe mbështetëse, si dhe ndryshimin e materialeve dhe temave mësimore. Programet e studimit mund të kalojnë ndryshime profilizuese deri në masën 20% sipas legjislacionit në fuqi. Akreditimi ka një rol të rëndësishëm në identifikimin e nevojave për përmirësim, përmes vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të programit, dhe mund të çojë në vendime për ndryshime të strukturuar dhe të bazuara. Njësitë përgjegjëse përdorin informacionet e mbledhura gjatë një cikli të plotë të programit për të kërkuar ndryshime dhe përmirësime në përputhje me periudhën e parashikuar të akreditimit.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ vëren se institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për të rritur ndërgjegjësimin dhe informimin e tyre në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit. Këto aktivitete zhvillohen nga Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë, e cila angazhohet në trajnimin dhe informimin e të gjithë aktorëve të përfshirë, duke siguruar një përfshirje të vazhdueshme dhe një angazhim të përbashkët për rritjen e cilësisë. Detajet e këtyre aktiviteteve janë të disponueshme përmes linkeve të publikuara në faqen e internetit të universitetit.
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka arritur të përmbushë në mënyrë të kënaqshme kërkesat e standardit për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë të qarta dhe transparente, dhe janë publikuar përmes platformave të dedikuara për të siguruar informimin e të gjithë aktorëve të përfshirë. Vlerësimet e programeve të studimit janë gjithashtu të hapura dhe shoqërohen me plane masash konkrete për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Aktivitetet për ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve janë të organizuara rregullisht, duke kontribuar në krijimin e një kulture të përmirësimit të qëndrueshëm të cilësisë.</i> <i>Ky proces është i mbështetur nga monitorimi i vazhdueshëm, feedback-u i studentëve dhe angazhimi i ekspertëve të jashtëm, duke siguruar kështu efektivitetin dhe ndikimin pozitiv në përmirësimin e programeve të studimit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Infermieri”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi mësimor është i organizuar dhe strukturuar sipas legjislacionit në fuqi. Programi dhe plani mësimor ka shpërndarje promociionale të ETC midis lëndëve teorike dhe praktike dhe praktikës profesionale, ku praktika profesionale, praktika dhe labororet mësimore përbëjnë 48% të orëve të programit mësimor;
2. Staf i akademik i angazhuar në njësinë kryesore dhe bazë ku realizohet ky program studimi është i kualifikuar me tituj dhe grada shkencore;
3. Marrëveshje bashkëpunimi të Universitetit “Barleti” me institucione shëndetësore publike dhe jo publike, ju mundësojnë studentëve kryerjen e praktikës profesionale dhe intershipe;
4. Funksionimi i bordit të karrierës i cili ndihmon studentët në orientimin profesional dhe punësim nëpërmjet krijimit të kontakteve me drejtuesit e këtyre institucioneve apo organizatave. Bashkëpunim me biznesin ndihmon në përmirësimin e programit të studimit dhe njohjen me nevojat e tregut të punës;
5. Institucioni ka kapacitetet, burimet financiare të qëndrueshme, infrastrukturën fizike dhe logjistike të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, si programin teorik dhe praktik. Laboratorët mësimorë janë të personalizuar dhe të specializuara sipas llojit dhe profilit të moduleve që zhvillohen;
6. Institucioni ofron shërbime të strukturuar për këshillimin e karrierës, mundësi për zhvillim profesional dhe ndërveprim me punëdhënësit e ardhshëm nëpërmjet Klubit të Karrierës dhe rrjetit të strukturave të Grupit Barleti;

a. Pika të dobëta:

1. Mungesa titullarëve të lëndëve nga kategoria profesor, në disa lëndë; (*Standardi II.3, kriteri 4*)
2. Fusha e formimit profesional të stafit akademik, në disa raste nuk përputhet me lëndët që ata realizojnë në këtë program studimi; (*Standardi III.1, kriteri 4*)

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

3. Realizimi në disa raste, nga një pedagog me shumë se tre lëndë; (*Standardi IV.1*)

Rekomandime

1. Titullarët e lëndëve të përzgjidhen nga kategoria profesor;
2. Rishikimim e ngarkesës mësimore të stafit akademik dhe shpërndarjen të drejtë të lëndëve mësimore stafit akademik sipas formimit të tyre profesional dhe fushës së ekspertizës që zotërojnë;
3. Dokumenti i aktiviteve të zhvilluara nga stafi akademik (tematika, lektoret pjesëmarrësit etj) mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit si leksione të hapura dhe seminare;
4. Institucioni të nxixë pedagogët për përditësimet e titujve në bibliotekë dhe ti mbështesë pedagogët për botimin e cikleve të leksioneve në gjuhën shqipe të përshtatura me kurrikulat përkatëse;

Conclusions of the Evaluation of the First Cycle Bachelor's Study Program in "Nursing"

a. Strengths and affirmations:

1. The curriculum is organized and structured according to the legislation in force. The curriculum and teaching plan have a promotional distribution of ETC between theoretical and practical subjects and professional practices, where professional practice, teaching practices and teaching laboratories constitute 48% of the curriculum hours;
2. Qualified academic staff with scientific titles and degrees, engaged in the main and basic unit where this study program is implemented;
3. Partnership and Cooperation agreements of university UBa with public and non public health care institutions enable students to carry out professional practice and internships;
4. The functioning of the career board which assists students in professional orientation and employment through the establishment of contacts with the leaders of these institutions or organizations. Also, cooperation with business helps in improving the study program and familiarization with the needs of the labor market;
5. The institution has the capacities, stable financial resources, sufficient and appropriate physical and logistical infrastructure for the development of teaching activities both the theoretical and laboratory practices. Teaching laboratories are personalized and specialized according to the type and profile of the modules being developed;

6. The institution offers structured services for career counseling, opportunities for professional development and interaction of students with future employers through the Career Club and the network of Barleti Group structures;

b. Weaknesses:

1. Absence of the course holders from the professor category, some courses subjects; (*Standard II.3, criterion 4*)
2. Professional education / expertise field of academic staff, in some cases, does not match with curriculum / subjects they develops in this study program; (*Standard III.1, criterion 4*)
3. In some cases, more than three subjects/ curriculum have been developed by one lecturer; (*Standard IV.1*)

Rekomandations

1. The course holders should be the academic staff of the professor category;
2. Review of the teaching load of academic staff and the distribution of teaching subjects to academic staff according to their professional training and field of expertise they possess;
3. Documentation of activities carried out by academic staff (as lecture, topics, participants etc) on new developments in science and technology within/outside the structure of the study program;
4. The institution should encourage lecturers to update the titles in the library and support lecturers in publishing lecture cycles in Albanian adapted to the relevant curricula;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

